Praktikat mësimore kanë treguar se jo të gjithë nxënësit mësojnë në të njëjtën mënyrë, në të njëjtën kohë dhe me ritëm të njëjtë. Për këtë arsye, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies duhet të jene të larmishme dhe t'u përshtaten nevojave dhe interesit të nxënësve. Ato duhet të nxisin bashkëpunimin mes nxënësve me qëllim të përforcimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënësve.

Shpjegimi është një prej metodave që në raste të veçanta është i domosdoshëm, por, megjithatë, mësimdhënia ndërvepruese ka përparësi në nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve.

Mësimdhënia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësive për ndërtimin e të kuptuarit të koncepteve, zgjerimin e njohurive, zhvillimin e strategjive matematike për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme.

Zgjidhja e problemeve është tipar i të menduarit, që në matematikë zë një vend të rëndësishëm. Ajo është pjesë e integruar në të gjitha kategoritë e përmbajteve mësimore. Në vitet e para të mësimin të matematikës nxënësit shfrytëzojnë teknika të thjeshta, kurse në klasën e tetë mbi bazën e njohurive të fituara ata vlerësojnë cilësinë dhe rrjedhimet e metodave komplekse të zgjidhjes së problemeve.

Zgjidhja e problemeve është një proces "provues" që përmban fillime e mbarime, suksese e dështime, dhe verifikime e mospranime të disa përfundimeve. Është e rëndësishme që mësimdhënësit të provojnë këtë proces në klasat e tyre dhe të bashkëpunojnë me nxënësit për kërkime të përgjigjeve. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit inkurajojnë nxënësit që të bëjnë të njëjtën gjë dhe u ndihmojnë atyre të fitojnë përvoja të reja e të vlerësojnë sukseset gjatë zgjidhjes së problemeve. Veprimtaritë që organizohen në klasë gjatë zgjidhjes së problemeve duhet të gërshetojnë punën individuale, në çifte dhe në grupe me qëllim të rritjes së përgjegjësisë së nxënësit për të ndërtuar të kuptuarit.

Pyetjet dhe teknika e pyetjeve zë një vend parësor në planifikimin e mësimdhënies. Nëse dëshirojmë të nxisim të menduarit e nxënësve, si pjesëmarrës aktivë në procesin e të nxënësve, është e domosdoshme të planifikohen pyetje të të gjitha niveleve. Kur të gjitha pyetjet janë të nivelit riprodhues, atëherë ndodh pak ose aspak të menduarit. Pyetjet e

nivelit të lartë, që zakonisht fillojnë me “Si...?”, “Pse...?” dhe “Çfarë...?”, janë pyetje nxitëse që kërkojnë nga nxënësi të mendojë dhe të reflektojë për atë që ka mësuar.

Komunikimi si një nga qëllimet më të rëndësishme të programit të matematikës u mundëson nxënësve të përdorin saktë gjuhën e matematikës. Është me rëndësi që gjatë procesit të nxënësve të dëgjojnë, të pyesin, të diskutojnë, të lexojnë dhe të shkruajnë. Shprehja e ideve matematike dhe diskutimi i tyre luan rol të rëndësishëm në të kuptuarit e koncepteve. Simbolet dhe diagramet e pasurojnë gjuhën e zakonshme të nxënësve, e zgjerojnë fjalorin shprehës dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë në të gjitha fushat.

Lidhja ndërlëndore paraqet një aspekt të rëndësishëm në edukimin matematik. Përvojat që sjellin në klasa mësimdhënësive u mundësojnë nxënësve të shohin se konceptet dhe shkathtësitë nga një kategori e matematikës janë të lidhura me ato të kategorive të tjera. Në raste të tilla, nxënësit ndihmohen të zotërojnë parimet e përgjithshme matematike. Po ashtu, lidhja e matematikës me lëndët e tjera dhe me situatat e jetës së përditshme paraqet një tjetër fakt, që e bën matematikën më shumë se një shkencë të izoluar.

Edukata fizike ofron raste të panumërta të matjeve si pjesë të natyrshme të aktiviteteve, për shembull, kohëmatjet ose matjet e gjatësive gjatë kërcimeve. Krijimi i figurave simetrike dhe asimetrike në mësimet e gjimnastikës gjithashtu paraqesin shfrytëzimin real të koncepteve matematike. Gjuha matematike haset në të gjitha fushat, për shembull, leximi i notave muzikore apo përshkrimi i figurave në aktivitetet e artit pamor. Po ashtu, përkthimi i gjuhës së përditshme në atë algjebrike dhe anasjelltas është pjesë e leximit të formulave të lëndëve shkencore. Zgjidhja e ekuacioneve shkronjore mundëson zgjidhjen e problemeve nga fizika dhe kimia. Kështu, lidhjet dhe zbatimi i njohurive matematike në fusha të ndryshme e rrit interesimin e nxënësve për mësimin e matematikës.

VLERËSIMI

Procesi i vlerësimit është pjesë e integruar e mësimdhënies dhe e të nxënësve. Përmes vlerësimit të vazhdueshëm gjykohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve, por edhe vlefshmëria e programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi. Mësimdhënësi duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësve dhe në shqyrtimin e

aftësive dhe të shkathtësive të ndryshme të tyre. Në klasën e shtatë nxënësit pësojnë ndryshime të mëdha në arritjet matematike, ndryshime të shpejta në rritjen e tyre intelektuale dhe në zhvillimin emocional. Prandaj, gjatë vlerësimit përcaktohet jo vetëm çfarë dinë nxënësi dhe çfarë mund të bëjë ai, por edhe çfarë ndjen dhe çfarë beson ai. Këto informata i mundësojnë mësimitdhënësit të organizojë orët mësimore në mbështetje të nevojave dhe të interesave të ndryshme të nxënësve. Të dhënat dhe mbledhja e informatave ndihmojnë gjithashtu në marrjen e vendimeve të vlefshme për motivimin dhe inkurajimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve.

Ndonëse aftësitë në llogaritje janë qenësore, vlerësimi duhet të përfshijë edhe verifikimin e aftësive të nxënësit për përdorimin e saktë të gjuhës e simboleve matematike gjatë komunikimit matematik, si dhe vlerësimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve. Për këto arsye në orët e matematikës shfrytëzohen teknika të ndryshme vlerësimi si:

Vrojtimi dhe regjistrimet në klasë vlerësojnë shkathtësitë e manifestimit dhe sjelljet e ndryshme të nxënësve.

Detyrat kontrolluese shërbejnë për kontrollimin e përparimit të nxënësve dhe identifikimin e vështirësive në të mësuar.

Dosja dhe projektet paraqesin koleksione të punimeve të përzgjedhura të mbajtura në një folder, të cilat sigurojnë një model të punës së nxënësit, të kryerë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Vlerësimi i dosjes bëhet nga mësimitdhënësi, prindi dhe nga vetë nxënësi.

Testimi është një procedurë që i shërben vlerësimit për qëllime të shumëfishta. Testet e ndërtuara nga mësimitdhënësi janë instrumentet më të përdorshme për vlerësimin e nxënësve. Llojet e ndryshme të testeve mundësojnë sigurimin e informacioneve për çdo nxënës në përmbushje të rezultateve të pritshme dhe objektivave të lëndës së matematikës, identifikimin e vështirësive në të mësuar dhe tejkalimin e tyre dhe vlerësimin e gatishmërisë së nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Strategjitë dhe teknikat e ndryshme mundësojnë vlerësimin e shkathtësive matematike, si: arsyetimin matematik, zgjidhjen e problemeve dhe komunikimin matematik.

Për shënimin e përparimit të nxënësve dhe notimin e tyre, mësimitdhënësi mund të përdorë modele të ndryshme, që janë më të përshtatshme dhe që japin informacione të pasura. Këto shënime dhe informacione kanë rëndësi të madhe për të kontribuar në motivimin dhe përparimin e mëtejshëm dhe për të komunikuar me prindërit dhe të gjitha institucionet e interesuara.

VII. LITERATURA EKSISTUESE

1. R. Zejnullahu, E. Hamiti, S. Bilalli, R. Lekaj, *Matematika 8*, Prishtinë, 2003.
2. Ramadan Zejnullahu, Përmbledhje detyrash, *Matematika 8*, Prishtinë, 2003.
3. I. Shehu, S. Bilalli, M. Kadriu, R. Lekaj, *Matematika 8, Detyra të zgjedhura*, Pr., 2003.
4. Nazmi Hyseni, *MATEMATIKA me përmbledhje detyrash*, Prishtinë, 1999.
5. Material plotësues nga literatura të ndryshme dhe nga interneti.

HYRJE

Ky program parashikon që lënda e biologjisë të zhvillohet për 74 orë. Për fleksibilitet, në programin e biologjisë së kësaj klase janë parashikuar më shumë se më parë, orë praktike dhe orë në dispozicion (gjithsej 13 orë). Me këtë synohet që arsimtarit t'i jepet më shumë hapësirë për të përshtatur mësimin varësisht nga kushtet që ofron klasa, shkolla etj. Në trungun e përmbajtjes lënda ka një kategori dhe pesë nënkategori. Që do të thotë se kategoria e parë (Qeniet e gjalla dhe mjedisi) përfshin këto nënkategori: 1.1. Mjedisi jetësor dhe ekosistemet, 1.2. Qarkullimi i materies dhe i energjisë në ekosistem , 1.3. Ekosistemet natyrore dhe antropogjene, 1.4. Zhvillimi i botës së gjallë dhe 1.5. Njeriu dhe mjedisi jetësor.

Marrë në përgjithësi, programi i biologjisë ka karakter linear dhe ciklik. Por, duke sublimuar informacionet e marra për programet e kohës në rajon e më gjerë, jemi përpjekur që në fushën e programeve të biologjisë sipas kurrikulit të ri të sigurojmë “rrjedhën” e koncepteve nga niveli i parë në të dytin dhe prej të dytit në nivelin e tretë. Kjo prirje është shoqëruar me një përzgjedhje të kujdesshme të lëndës, p.sh. Mjedisi jetësor dhe ekosistemi, ekosistemet natyrore dhe antropogjene etj. me të vetmin synim që përmbajtja programore e biologjisë të jetë koherente, logjike dhe e aplikuar. Veçori tjetër e programit të reformuar të biologjisë në përgjithësi, e në veçanti të kl. VIII, është “përzierja” e temave mësimore. Për dallim prej programeve tradicionale, ku, p.sh., njohuritë nga botanika, zoologjia, fiziologjia etj, jepeshin të veçuara nga njëra-tjetra me “përzierjen” e temave ato jepen në mënyrë të integruar. Kjo qasje u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri të domosdoshme për jetën e përditshme konform kërkesave të mileniumit të ri dhe hap rrugën e përvetësimit më të lehtë të koncepteve të tjera që shpalosen në vazhdim të shkollimit.

Në fund po theksojmë se ngjashmëritë që viheshin në emërtimin e kategorive dhe të nënkategorive në nivelin e parë, të dytë dhe të tretë të shkollimit, me zberthimin e tyre tematik për çdo orë mësimore kanë ndryshime të dukshme në përmbajtje dhe në qasje.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së biologjisë ka për qëllim:

- ❖ Zhvillimin dhe aftësimin e nxënësve për të njohur dhe për të kuptuar ligjshmëritë themelore të ekologjisë dhe të zhvillimit evolutiv të botës së gjallë.
- ❖ Zhvillimin e njohurive për ekologjinë, evolucionin e gjallesave dhe të aftësive për të vlerësuar zhvillimin evolutiv të qenieve të gjalla si dhe ruajtjen e baraspeshës ekologjike në natyrë.
- ❖ Zhvillimin e aftësive për përdorimin dhe vlerësimin e teksteve, atlaseve, literaturës biologjike, programeve arsimore, televizioneve dhe burimeve të tjera të informacionit.
- ❖ Zhvillimin e shkathtësive për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave relevante shkencore dhe të zbatimit të shkathtësive të fituara në situata konkrete për të mirën e njeriut dhe të mjedisit jetësor.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:**
 - Në kontest të ndërgjegjësimit dhe të ngritjes së përgjegjësimit etik ndaj botës së gjallë dhe mjedisit jetësor me qëllim të ruajtjes së baraspeshës ekologjike në natyrë;
 - Në kuptim të kultivimit të sjelljeve personale (të jetë kooperative, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj.).
- **Të njohë:**
 - Fjalorin (terminologjinë biologjike);
 - Faktet, konceptet dhe parimet ekologjike, etologjike dhe të evolucionit;
 - Procedurat dhe metodat në biologji.
- **Të kuptojë:**
 - Faktet dhe parimet biologjike dhe të bëjë ndërlidhjen logjike të tyre;

- Arsyetimin e metodave dhe të punës praktike në mjedisin natyror dhe në laborator;
- Procedurave.
- **Të zbatojë në situatë të reja:**
 - Faktet dhe parimet ekologjike, etologjike dhe të evolucionit;
 - Zgjedhjen e problemeve të natyrës biologjike.
- **Të komunikojë informatat në kontekste të ndryshme:**
 - Shkrimi i raportit nga një punë praktike ose hulumtim;
 - Prezantojë rezultatet e hulumtimit duke konsultuar shumë burime të informacionit;
 - Kontribuojë në debate dhe diskutime për çështje ekologjike, etologjike dhe të evolucionit.
- **Të zhvillojë të menduarit kritik nga biologjia:**
 - Të njohë informatën relevante nga ajo jorelevante;
 - Të dallojë faktin nga gjykimi;
 - Zbatojë parimet biologjike në zgjedhjen e problemeve;
 - Interpretimi i materialit ilustrues;
 - Të analizojë shkaqet dhe rrjedhojat që sjell çrregullimin e një faktori ekologjik në një ekosistem natyror dhe antropogjen;
 - Të vlerësojë rolin pozitiv dhe human të njeriut për natyrën e gjallë dhe jo të gjallë.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Organizimi i përmbajtjes përfshin: ndërtimin, balancimin dhe mbarëshkrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin një kategori kryesore në të cilën përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara të përmbajtjes sipas rëndësisë së tërësive mësimore.

Mbarëshkrimi i përmbajtjes së lëndës në klasë bëhet për 74 orë mësimi, sipas trajtës:

- Kategoria
- Nënkatëgoria

- Përmbajtja programore
- Rezultatet e pritura
- Lidhja ndërlëndore

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	Orët	%
I. QENIET E GJALLA DHE MJEDISI	I.1. MJEDISI JETËSOR DHE EKOSISTEMET	20	27.0
	I.2. QARKULLIMI I MATERIES DHE I ENERGJISË NË EKOSISTEM	7	9.5
	I.3. EKOSISTEMET NATYRORE DHE ANTROPOGJENE	14	18.9
	I.4. ZHVILLIMI I BOTËS SË GJALLË	11	14.8
	I.5. NJERIU DHE MJEDISI JETËSOR	9	12.2
	Punë praktike	10	13.5
	Orë në dispozicion	3	4
	Gjithsej	74	100%

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
I. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	I.1. Mjedisi jetësor dhe ekosistemet	Organizmat janë të varur nga kushtet e mjedisit jetësor dhe nga marrëdhëniet ndërmjet organizmave (nacionet themelore ekologjike) Kushtet jetësore të mjedisit (faktorët ekologjikë) Ndërtimi i ekosistemit (biotopi dhe biocenoza, prodhuesit, harxhuesit dhe zbërthyesit) Marrëdhëniet jetësore në ekosistem (rrjeti trofik, piramidat ekologjike etj.) Bashkësia jetësore dhe organizimi i saj (popullata, nisha ekologjike, organizimi kohor dhe hapësinor etj.)	Nxënësit në fund të klasës së tetë nga kjo përmbajtje programore duhet: Të njohin dhe të kuptojnë nocionet themelore ekologjike. Të dinë dhe të analizojnë varshmërinë e organizmave nga kushtet e mjedisit jetësor dhe marrëdhëniet ndërmjet vetë organizmave. Të përshkruajnë ndërtimin e ekosistemit. Të kuptojnë dhe të klasifikojnë faktorët ekologjikë. Të analizojnë rrjetin trofik dhe piramidat ekologjike në ekosistem. Të hulumtojnë dinamikën e popullatës në aspektin kohor dhe hapësinor.	Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me: Kiminë - në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të ambientit jetësor. Fizikën – në pikëpamjen e faktorëve fizik dhe ndryshimeve fizike të ambientit jetësor.
I. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	I.2. Qarkullimi i materies dhe i energjisë në ekosistem	Në biosferë dhe në ekosistem bëhet qarkullimi i vazhdueshëm i materieve dhe i energjisë (qarkullimi i oksigjenit, dioksidit të karbonit, azotit, ujit etj.)	Nxënësit në fund të klasës së tetë nga kjo përmbajtje programore duhet: Të kuptojnë fluksin e energjisë dhe ciklin e materies në ekosisteme. Të analizojnë qarkullimin e ujit në natyrë. Të krahasojnë qarkullimin e oksigjenit	Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me: Kiminë - në aspektin e njohjes së elementeve kimike që

			me atë të dioksidit të karbonit, azotit e fosforit.	marrin pjesë në ndërtimin e organizmave. Fizikën – në aspektin e njohjes së ligjshmërive fizike të optikës, termodinamikës.
I. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	I.3. Ekosistemet natyrore dhe antropogjene	Organizmat krijojnë marrëdhënie të ngushtë me mjedisin jetësor dhe komunikojnë mes vete pa ndërmjetësimin e njeriut – ekosistemet natyrore dhe me ndërmjetësimin e njeriut – ekosistemet artificiale (ekosistemet rurale dhe urbane). Ekosistemet ujore dhe tokësore. Bimët endemike dhe shtazët e rrezikuara në Kosovë. Sjellja e organizmave në natyrë – etologjia.	Nxënësit në fund të klasës së tetë nga kjo përmbajtje programore duhet: Të dallojnë ekosistemet natyrore nga ato artificiale. Të njohin rezervatet, monumentet natyrore dhe parqet nacionale të Kosovës. Të dinë për bimët endemike dhe shtazët e rrezikuara të Kosovës. Të kuptojnë veçoritë e ekosistemeve ujore dhe tokësore. Të analizojnë sjelljen e shtazëve dhe komunikimin e tyre mes vete. Të njihen me ndryshimet dhe qëndrueshmërinë e popullatave në natyrë.	Përmbajtja programore e kësaj tërësie ka ndërlidhje me: Gjeografinë – në kuptimin e njohjes së hidrografisë, hidrologjisë dhe pedologjisë. Kiminë – përbërjen kimike të ujit, tokës etj.
I. Qeniet e gjalla dhe	I.4. Zhvillimi i botës së gjallë	Organizmat bimorë dhe shtazorë janë zhvilluar në kushte të ndryshme të	Nxënësit në fund të klasës së tetë nga kjo përmbajtje programore duhet: Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe	Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndër-

mjedisi		mjedisit jetësor dhe kanë qenë të varur nga faktorët e ndryshëm të evolucionit. Fillet e jetës dhe historiati i zhvillimit të botës së gjallë. Epokat gjeologjike.	përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me evolucionin. Të analizojnë dhe të përshkruajnë faktorët e ndryshëm evolutivë që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e gjallesave. Të kuptojnë teoritë e zhvillimit të botës së gjallë.	lidhje me : Gjeografinë – në kuptimin e njohjes së shtresave të ndryshme të dheut. Sistematikën - në kuptimin e njohjes së llojeve si ndërtues të sistemeve ekologjike.
I. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	I.5. Njeriu dhe mjedisi jetësor	Njeriu në mjedisin jetësor shpesh ndikon në ndërrimet e kushteve fizike dhe kimike të tij (ndotja), por njeriu gjithashtu merr masa të ndryshme edhe për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor. Ndotja e mjedisit jetësor dhe pasojat. Efekti i serrave. Mbiplehrosja. Shkatërrimi i ekosistemeve natyrore. Mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor.	Nxënësit në fund të klasës së tetë nga kjo përmbajtje programore duhet: Të identifikojnë treguesit e ndryshëm të ndotjes së mjedisit jetësor. Të kuptojnë pasojat e shkatërrimit të ekosistemeve natyrore. Të kontribuojnë në mbrojtjen dhe ruajtjen e llojeve të rrezikuara në Kosovë. Të njihen me pasojat e ndryshimeve globale të planetit tonë. Të parashikojnë ndryshimet e mjedisit jetësor të vendbanimit ku jetojnë. Të dinë për kultivimin e bimëve dekorative. Të zbatojnë kodin ligjor për mbrojtjen e mjedisit jetësor.	Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me: Kiminë – në aspektin e ndërrimeve cilësore të mjedisit jetësor si dhe elementeve të ndryshme kimike që shkaktajnë ndotjen e mjedisit jetësor. Fizikën – në kuptimin e njohjes së faktorëve fizikë dhe të ndryshimeve fizike të mjedisit jetësor.

Punë praktike

Me fjalën punë praktike kuptojmë aktivitetet që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim të konkretizimit të pjesës teorike të lëndës.

Në mungesë të laboratoreve, punët praktike mund të kryhen edhe në klasë, me kusht që materiali dhe mjetet e punës praktike paraprakisht të sillen në klasë.

Punët laboratorike nuk janë ndonjë metodë e veçantë e mësimin, por janë formë e organizimit të punës mësimore, gjatë së cilës nxënësi në bashkëpunim me arsimtarin vrojtojnë strukturat, proceset dhe fenomenet e ndryshme jetësore gjatë organizimit të mësimin në natyrë.

Disa nga punët praktike, të cilat do të duhej të realizoheshin në mësimin e biologjisë për klasën e tetë, janë:

- Dalja në natyrë dhe vëzhgimi i një ekosistemi ujor ose tokësor në afërsi të vendbanimit.
- Njohja me pamjen e përgjithshme dhe përcjellja e ndryshimeve fenologjike gjatë stinëve.
- Vëzhgimi i migrimit të shtazëve, ndërtimit të çerdheve, kujdesi për pasardhësit etj.
- Vizitë e kopshtit zoologjik.
- Vëzhgimi i shtazëve të ndryshme që paraqesin etapa të ndryshme të zhvillimit evolutiv të shtazëve.
- Hulumtimi i shtazëve dhe i bimëve të rrezikuara të Kosovës.

Ekskursioni mësimor

Është një nga metodat më të efektshme për përvetësimin aktiv të njohurive teorike.

Organizimi i mirë i ekskursionit zhvillon te nxënësit aftësinë e përvetësimit, vëzhgimit, analizës, sintezës, kujtesës logjike, intuitës, të menduarit të pavarur dhe krijues, që ndikojnë drejtpërdrejt në përvetësimin e vetëdijshëm dhe të qëndrueshëm të njohurive shkencore biologjike.

Të mos merret nga nxënësi ekskursioni si **“një shëtitje e thjeshtë në natyrë”**.

Ai duhet të përgatitet nga arsimtari. Kjo nënkupton se edhe arsimtari paraprakisht duhet të përgatitet për ekskursion, duhet të ketë përgatitje komplete profesionale biologjike dhe orientime të qarta didaktike.

Puna përgatitore e arsimtarit për ekskursion:

Masat organizative dhe metodike

- Arsimtari duhet të njihet paraprakisht me terrenin e ekskursionit dhe në përputhje me qëllimet e temës së ekskursionit, cakton lokacionin (p.sh. lumi, livadhi, pylli, agrokultura, parku nacional etj.).
- Të njohë mirë terrenin ku zhvillohet ekskursion; botën bimore dhe shtazore të tij, konfiguracionin e terrenit etj. Për shkaqe didaktike, është mirë që rruga e kthimit të mos jetë e njëjtë me atë të shkuarjes.
- Nëpërmjet ekskursionit arsimtari i udhëzon nxënësit të zotërojnë dhe të përvetësojnë vetë njohuritë sipas temës së ekskursionit.
- Përmes ekskursioneve në terren arsimtari këmbëngul që nxënësit të dallojnë thelbësoren nga jothelbësorja në dukuritë e botës bimore dhe shtazore, të zbulojnë marrëdhëniet e brendshme dhe lidhjet e varësisë së ndërsjellë midis gjallesave të mjedisit ku jetojnë.
- Pas kthimit nga ekskursion i mësimit, arsimtari jep këshilla si duhet të veprohet me materialin e mbledhur bimor apo shtazor.

METODOLOGJIA

Mësimi në biologji si dhe në çdo lëmë tjetër mund të kryhet në disa mënyra, d.m.th mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim i cili realizohet me metoda të ndryshme, ku secila sosh ka rol dhe rëndësi të veçantë metodike.

Çdo lëndë, përpos metodave të përgjithshme mësimore, i ka edhe metodat e veçanta. Prej metodave të shumta që mund të përdoren në mësimet e biologjisë po përmendim:

- Metodën e të shprehurit me gojë (monologu);
- Metodën e bashkëbisedimit (dialogu);
- Metodën e leximit dhe të punës me tekst;

- Metodën e punës praktike në laboratorin biologjik apo në terren (ekskursionet);
- Metodën e të mësuarit dhe të nxënit ndërveprues (në kompjuter, CD programe etj.).

Çdo metodë mësimore i ka anët pozitive dhe negative. Kjo do të thotë se me zbatimin e një metode të vetme mësimore nuk mund të realizohen të gjitha qëllimet dhe detyrat e mësimit të lëndës së biologjisë. Prandaj, ato patjetër duhet të kombinohen në varësi nga përmbajtja, qëllimet dhe objektivat të cilët synohen të realizohen.

Kompetenca e arsimtarit është që, duke zbatuar strukturën ERR të orës, të zgjedhë materiale të shumëllojshme didaktike, metoda dhe strategji më të përshtatshme të mësimdhënies dhe të nxënies me synim të realizimit të qëllimeve dhe të objektivave specifike, me nxënësin në **qendër (p.sh. klaster, kubimi, insert, tabela e koncepteve, diagrami i Venit, brainstorming, xhigsou I dhe II etj.)**.

Për hollësi të këtyre formave të punës me nxënës dhe të teknikave të mësimdhënies shih tekstet:

B.Musai; Modele të mesimdhënies së suksesshme, Tiranë, e-mail; rëct ara@aedp-soros.al.

M. Mula. Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR të orës Prishtinë, 2003, e-mail:office @ kec-ks.org, http://www. Kec-ks.org.

Plani dhe programi mësimor për klasën e nëntë dhe të dhjetë, Prishtinë, 2002, dhe 2003 f. 11 -14 dhe f.167-169.

Në praktikë thuajse nuk ekziston orë e biologjisë në të cilën aplikohet vetëm një metodë mësimore. Me zbatimin e disa metodave mësimore në të njëjtën orë të mësimit, ora bëhet më dinamike, thyhet monotonia dhe ngritet interesimi i nxënësve për mësim.

Çdo ndryshim në punë, pra edhe zbatimi i metodave të ndryshme mësimore, e freskon mësimin, e bën shumë më interesant, me çka arrihet që rezultatet në nxënie të jenë më të mira.

Për realizimin sa më të mirë të qëllimeve të parashtruara, në orën mësimore duhet të punojmë në frymën e parimeve didaktike: prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e ndërlikuara, prej konkretes kah abstraktja dhe prej të përgjithshmes kah e veçanta.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shikallë nxënësi ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në objektivat e dijes (rezultatet e prituara) të programit të lëndës së biologji për klasën VIII.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore, siç janë:

- Përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- Zbatimi i instrumenteve përkatëse të matjes në përputhje me qëllimin, në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- Sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- Matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- Vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- Zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të të cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

Instrumentet e vlerësimit

Është me rëndësi se për veçoritë që duam t'i vlerësojmë duhet të përdorim mjetin apo instrumentin përkatës të matjes. Me çfarëdo mjeti që përdoret nuk mund të maten të gjitha veçoritë e arritshmërisë së nxënësit, andaj duhet përdorur sa më shumë që të jetë e mundshme mjete dhe teknika të ndryshme, në mënyrë që të mbledhim informacione të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- Vrojtimi;
- Pyetësi (vetëvlerësimi);
- Raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- Të shprehurit me gojë;

- Të shprehurit me shkrim;
- Fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- Dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- Testi i bazuar në kritere dhe objektiva;
- Testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetjet) me
 - përgjigje alternative të shumta;
 - përgjigje të hapura të shkurta;
 - përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin e përmbajtjes programore të biologjisë për klasën VIII rekomandohet përdorimi i:

- **Biologjia** për klasën VIII.

Krahas tekstit shkollor, burim tradicional i mësimnxënies, për zbatimin e suksesshëm të përmbajtjeve mësimore sugjerojmë edhe përdorimin e doracakëve, si ndihmë shtesë në procesin mësimor (atlas botanik, zoologjik, anatomik, fjalori terminologjik). Fjalori i biologjisë, E. Ruka, Z. Bajram –Toena, Tiranë, 1999.

Gazeta, revista profesionale dhe shkencore, pastaj fotografi, postera, skema, diagrame, harta, tabela, preparate, CD, video-kaseta dhe burime të tjera nga interneti.

Është kompetencë e arsimtarit që në vartësi prej kushteve në të cilat punon shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuele, auditive, dhe audiovizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

HYRJE

Në këtë vit, niveli shkencor i fizikës ngritet më lart, por gjithnjë duke pasur parasysh moshën dhe aftësitë psiko-fizike të nxënësve. Nxënësit do t'i marrin njohuritë elementare të dukurive dhe të ligjeve fizike. Me disa prej tyre ata do të njihen për të parën herë (elektromagnetizmi, fizika bashkëkohor, etj.), e disa prej tyre janë vazhdim i tërësive mësimore të klasës VII (trupat dhe vetitë e tyre, dukuritë elektrike dhe magnetike), me ç'rast bëhet zgjerimi i njohurive, përshkrimi dhe sqarimi i dukurive fizike. Për shkak të rëndësisë së tyre, këto njësi mësimore duhet të përsëriten në mënyrë që njohuritë e fituara më parë të kuptohen më mirë dhe të ngritet niveli i tyre shkencor, duke futur koncepte të reja, si: nxitimin, energjinë kinetike dhe potenciale etj.

Nëpërmjet lëndës së fizikës nxënësit do të njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e ligjeve të natyrës. Në këtë mënyrë ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë si dhe fitojnë shkathtësi jetësore dhe shprehi të punës.

Fizika si shkencë e natyrës së bashku me shkencat e tjera ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

QËLLIMET**Programi mësimor i lëndës së fizikës ka për qëllim:**

- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për vrojtimin e dukurive fizike, përgjithësimin dhe zbatimin e tyre në zgjidhjen e detyrave praktike dhe problemeve të jetës së përditshme.

- Zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të përhershme për të matur madhësitë e ndryshme fizike, përpunimin e të dhënave eksperimentale dhe zbatimin e tyre në situata konkrete.
- Zhvillimin e shprehive për kursimin e energjisë dhe shfrytëzimin racional të saj.
- Zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësimin për të përdorur literaturë dhe burime të tjera për nxënie.
- Të vetëdijësohet dhe të aftësohet për vlerësimin dhe ruajtjen e mjedisit jetësor.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të njohin

- dukuritë fizike, pozitën e trupave, lëvizjen e tyre, pasojat që i shkakton ndryshimi i shpejtësisë së lëvizjes së trupave (*nxitimi i trupave*), madhësitë që i ndërldhin ato dhe njësitë e tyre të matjes;
- diagramet e fazave dhe fazat si përgjithësim i gjendjeve agregate;
- konceptin elementar të nxitimit dhe të forcës;
- rrymën alternative dhe trefazore, mënyrën e përfitimit dhe vetitë kryesore të saj;
- mënyrën jonike të përcjelljes së rrymës elektrike në lëngje dhe gaze;
- procesin e matjes, grumbullimin, sistematizimin dhe përpunimin e të dhënave.

Të kuptojnë

- se shumë dukuri fizike (*termike, elektrike*) mund të sqarohen duke u bazuar në ndërtimin grimcor të lëndës;
- se energjia paraqitet në lloje të ndryshme, e cila mund të bartet dhe të shndërrohet në lloje të tjera;
- paraqitjen simbolike të madhësive fizike (*energjisë kinetike, potenciale, nxitimit, shpejtësisë mesatare, ligjit themelor të lëvizjes $F = ma$, etj.*) dhe njësive për matjen e tyre;

- lidhjet kualitative dhe kuantitative ndërmjet madhësive të ndryshme fizike;
- procesin e matjes, grumbullimin, sistematizimin dhe përpunimin e të dhënave.

Të zbatojnë

- njohuritë e fituara për matjen e madhësive të ndryshme fizike në zgjidhjen e detyrave praktike nga jeta e përditshme;
- rezultatet e matjeve (p.sh., *kohën, largësinë, masën*) për të përcaktuar karakteristikat e lëvizjes së trupave dhe bashkëveprimin e tyre brenda sistemit fizik (p.sh., *forcën, shpejtësinë, nxitimin, energjinë potenciale dhe kinetike*);
- vlerat e matjeve për ndërtimin e diagrameve të proceseve të ndryshme fizike.

Të analizojnë

- me eksperimente dhe matje, dukuritë e ndryshme fizike dhe nga matjet e tyre të nxjerrin përfundime të duhura;
- dukurinë fizike ose ndonjë proces, duke e zbërthyer atë në madhësi të rëndësisë të dorës së parë, të dorës së dytë etj.

Të sintetizojnë

- njohuritë teorike, demonstrimet dhe matjet eksperimentale për shpjegimin e drejtë të dukurive fizike;
- njohuritë e reja me ato të vjetra dhe të vënë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë me anë të ndonjë modeli të përshtatshëm (*duke marrë parasysh ndërtimin molekular të lëndës, të sqarojë dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë*);
- dhe të klasifikojnë faktorët që shkaktojnë ndryshime brenda një sistemi fizik (p.sh., *shpejtësia, forca dhe nxehtësia*) dhe të parashikojë se çka do të ndërrohet dhe çka jo, kur lënda i nënshtrohet veprimet të forcave të jashtme ose ndryshimit të energjisë.

Të vlerësojnë

- rëndësinë e zbatimeve praktike të njohurive fizike në ndërtimin e aparateve dhe pajisjeve të ndryshme që mundësojnë jetë më të lehtë dhe më të mirë;

- saktësinë e gjykimëve të tyre me anë të fakteve dhe eksperimenteve.

Të zvillojë qëndrimet dhe vlerat

- të kuptojë përparësitë dhe kufizimet që i ofron lënda;
- në ndikimin e sjelljeve personale (*të jetë i ndershëm, tolerant, i hapur, të ketë vullnet, të jetë kooperativ, kritik, krenar etj.*).

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

<i>Kategoritë</i>	<i>Nënkategoritë</i>	<i>Kapitujt mësimorë</i>	<i>Nr. i orëve</i>	<i>Përqindja %</i>
I. Pozita dhe lëvizja e trupave	<i>I.1. Trupat dhe vetitë e tyre</i>	I.1.1. Lëvizjet dhe forcat	14	18,9
		I.1.2. Energjia dhe ligjet e ruajtjes	5	6,8
II. Lëvizja kaotike dhe dukuritë termike	<i>II.1. Struktura molekulare-kinetike e lëndës</i>	II.1.3. Nxehtësia dhe shndërrimet termike	12	16,2
III. Dukuritë elektrike dhe magnetike të lëndës	<i>III.1. Vetitë elektrike dhe magnetike të lëndës</i> <i>III.2. Elektromagnetizmi</i>	III.1.4. Fusha magnetike	12	16,2
		III.2.5. Induksioni elektromagnetik	12	16,2
IV. Drita dhe paraqitja e saj	<i>IV.1. Natyra e dritës dhe paraqitja e saj</i>	IV.1.6. Drita dhe përhapja e sajë	10	13,52
V. Fizika bashkëkohore	<i>V.1. Atomi dhe bërthama e tij.</i>	V.1.7. Ndërtimi i atomit dhe bërthama e tij	9	12,16

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA	LIDHJA NDËRLËNDORE
I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE	I.1. TRUPAT DHE VETITË E TYRE (19 orë)	I.1.1. Lëvizjet dhe forcat (14 orë)	Nxënësi duhet të jetë në gjendje : -t'i përshkruajë (përkufizojë) lëvizjet e njëtrajtshme dhe jo të njëtrajtshme; -t'i dallojë dhe t'i emërtojë këto lëvizje në shembujt e ndryshëm; -të përkufizojë ligjet e Njutonit; -të llogaritë forcën sipas ligjit themelor të lëvizjes në disa shembuj konkretë.	Me gjeografinë, astronominë, edukatën fizike, biologjinë, shkencat teknike etj.
		I.1.2. Energjia dhe ligjet e ruajtjes (5 orë)		

			- të vlerësojë E_k të dy trupave, duke u bazuar në shpejtësitë e tyre.	
II. LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE	II.1. STRUKTURA MOLEKULAR E –KINETIKE E LËNDËS (12 orë)	II.1.3. Nxehtësia dhe shndërrimet termike <ul style="list-style-type: none"> • Sasia e nxehtësisë. • Përcjellshmëria termike. • Konveksioni dhe rrezatimi • Shkrija dhe ngurtësimi • Avullimi, kondensimi dhe vlimi. • Nxehtësia specifike e trupit. • Shndërrimet e energjisë termike. • Ligji i përgjithshëm i ruajtjes së energjisë. 	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> - të përkufizojë termokapacitetin e trupit, termokapacitetin specifik të lëndës, fazat; - të tregojë se gjendjet agregate ndërrohen me ndryshimin e sasisë së nxehtësisë - të lexojë diagramet e fazave; - të dallojë fazat e gjendjes agregate në rastet e paraqitura në jetën e përditshme; - të përkufizojë ligjin e përgjithshëm të ruajtjes së energjisë; 	Me kiminë, biologjinë, gjeografinë, teknologjinë, industrinë.
III. DUKURITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS	III.1. VETITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS (12orë)	III.1.4. Fusha magnetike <ul style="list-style-type: none"> • Magnetet e përhershme dhe fusha magnetike. • Veprimi i fushës magnetike në përçuesin me rrymë. • Veprimi i përçuesit të rrymës elektrike në magnet. • Fusha magnetike e rrymës elektrike (Bobina, solenoidi dhe elektromagneti). 	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë fushën magnetike dhe të paraqesë grafikisht atë me anë të vijave të forcës; -të njohë vetitë e forcës magnetike; - të vërtetojë me anën e eksperimentit veprimin e fushës magnetike në përçuesin me rrymë dhe anasjelltas –veprimin e përçuesit të rrymës në magnet; 	Këto tërësi mësimore janë të lidhura me shkencat teknike dhe gjejnë zbatim të madh në industri.

		<ul style="list-style-type: none"> • Parimi i punës së instrumenteve matëse elektrike. 	<p>- të bëjë dallimin ndërmjet magnetit të përhershëm dhe elektromagnetit dhe t'i numërojë disa instrumente me elektromagnet;</p> <p>-të njohë parimin e punës së instrumenteve matëse.</p>	
III. DUKURITË ELKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS	III.2. ELEKTRO-MAGNETIZMI (12 Orë)	<p>III.2.5. Induksioni elektromagnetik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ç'është induksioni elektromagnetik? • Ligji i Faradejit për induksionin elektromagnetik. • Vetinduksioni. Rregulla e Lencit. • Rryma alternative. • Rryma trefazore. • Transformatorët. • Elektromotorët dhe gjeneratorët. 	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë induksionin elektromagnetik.; - të përkufizojë ligjin e Faradeit të induksionit elektromagnetik dhe rregullën e Lencit; - të tregojë si përfitohet rryma alternative dhe ajo trefazore; -të tregojë se parimi i punës së transformatorit dhe gjeneratorit bazohet në induksionin elektromagnetik. 	Këto njësi mësimore janë të lidhura me shkencat natyrore, teknike si dhe lidhen me jetën e përditshme aq shumë sa që sot nuk mund të mendohet jeta pa to.
IV. DRITA DHE PARAQITJA E SAJ.	IV.1. NATYRA E DRITËS DHE PARAQITJA E SAJ (10 orë)	<p>IV.1.6. Drita dhe përhapja e saj</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e dritës dhe përhapja e saj. • Eklipset (eklipsi i Diellit, i Hënës.) • Shpejtësia e dritës në mjedise të ndryshme. • Reflektimi i dritës në pasqyra të 	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'i numërojë disa burime të dritës dhe të shpjegojë si përhapet drita prej tyre. - të shpjegojë pse paraqitet hija dhe gjysmëhija; - të sqarojë eklipset e Hënës dhe të 	Industri, teknikë, mjekësi, astronomi, në jetën e përditshme etj.

		rrafshita. <ul style="list-style-type: none"> • Pasqyrat sferike. • Thyerja e dritës. 	Diellit; - t'i dallojë llojet e pasqyrave sferike dhe të paraqesë shëmbëllimin e trupit në pasqyra të rrafshita dhe sferike; - të bëjë dallimin mes shëmbëllimit real dhe virtual; - të tregojë se në cilat mjedise shpejtësia e dritës është më e madhe dhe të marrë dy shembuj kokret, duke llogaritur shpejtësinë e dritës në ajër dhe në qelq; - të ndërtojë periskopin e thjeshtë; - të përkufizojë ligjin e reflektimit dhe atë të thyerjes.	
V. FIZIKA BASHKOHORE	V.1. ATOMI DHE BËRTHAMA E TIJ (9 orë)	V.1.7. Ndërtimi i atomit dhe bërthama e tij <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i atomit. Jonet • Elektrizimi i trupave me fërkim dhe ndikim. • Rryma elektrike në metale dhe në elektrolit. • Rryma elektrike në gaze. • Rryma elektrike në boshllëk. 	- Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të tregojë cilat mikrogrimca e përbëjnë atomin, madhësinë e tyre; - të tregojë mënyrat e elektrizimit të trupave; - të përkufizojë njësinë e matjes së sasisë së elektricitetit (kuloni) - të tregojë se përcjellja e rrymës elektrike në elektrolite dhe në gaze është jonike.	Me kiminë biologjinë, mjekësinë, bujqësinë.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përvoja ka treguar se realizimi i procesit të mësimdhënies me metoda të ndryshme është shumë më efektiv dhe i suksesshëm. Prandaj, edhe mësimi i fizikës duhet të bëhet duke i shfrytëzuar dhe kombinuar metodat e ndryshme të mësimin. Këtu do t'i numërojmë vetëm ato metoda të cilat më shpesh dhe më shumë përdoren, e këto janë:

- Metoda e të shprehurit me gojë
- Metoda e bashkëbisedimit (këtu hyn edhe metoda aktive e mësimdhënies)
- Metoda e demonstrimit
- Metoda e punës eksperimentale.

Përveç këtyre metodave, përdoren edhe metoda dhe teknika të tjera të mësimdhënies, p.sh., **metoda interaktive**, e cila është mjaft produktive me punën në grupe dhe ekipe të nxënësve. Arsimitari i fizikës duhet t'i përdorë të dy këto metoda, edhe atë **aktive** edhe atë **interaktive**.

Mirëpo, kombinimi i këtyre metodave mësimore është më i suksesshëm, sepse zgjon kureshtjen dhe nxit interesimin e nxënësve. Mandej, pasojnë zbatimi konkret dhe praktik i njohurive në zgjidhjen e detyrave, që te nxënësi krijon kujtesë të pashlyeshme.

VLERËSIMI I DITURIVE TË NXËNËSVE

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike dhe të vazhdueshme, analizimit dhe interpretimit të të dhënave me qëllim të përcaktimit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat e përgjithshëm dhe specifike të lëndës së fizikës.

Qëllimi i vlerësimit, tregon cakun përfundimtar të një lloji vlerësimi, rezultatin përfundimtar që shtrohet për tu arritur me një metodë të caktuar të vlerësimit.

Në mënyrë që arsimtarit t'i lehtësohet puna e tij me nxënësin, i sugjerohet të punojë me këto teknika dhe lloje të vlerësimit:

- **Vlerësimi sipas aktivitetit**

Arsimitari duhet ta pranojë nxënësin si partner të bashkëbisedimit. Prandaj, duke provuar që nxënësin ta kyçë në bashkëbisedim gjatë

procesit të mësimit, njëkohësisht do ta vlerësojë se sa është në gjendje të pëvetësojë njësinë mësimore. Në këtë mënyrë nxënësi do të jetë vazhdimisht aktiv në marrjen e përfundimeve për ligjshmëritë që udhëheqin një dukuri fizike. Nxënësit e ndryshëm, për të njëjtën problematikë, mund të arrijnë në përfundime të ndryshme.

- **Vlerësimi me gojë (intervista)**

Ka nxënës që janë mjaft të përgatitur, por janë të tërhequr, jo aq aktiv dhe nuk marrin pjesë në bashkëbisedim. Për këtë arsye arsimtari duhet që këta nxënës t'i thërrasë dhe t'i pyesë me gojë në mënyrë klasike, në mënyrë që arsimtari të kuptojë nivelin e arritshmërisë së tyre. Edhe kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi me tërë nxënësit e klasës dhe veç e veç.

- **Vlerësimi nga zgjidhja e detyrave në klasë dhe në shtëpi**

Në programin e fizikës për klasën VIII janë paraparë zgjidhje detyrash, detyra për përsëritje dhe detyra kontrolli. Në këtë rast nxënësit duhet vazhdimisht të kyçen në zgjidhjen e këtyre detyrave në tabelë apo në fletore. Ky aktivitet i nxënësve duhet të merret si parametër për vlerësimin e diturisë.

- **Vlerësimi me anë të testeve**

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste, arsimtarit i ofron një pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që arsimtari do t'i kushtojë mënyrës së drejtë të përpilimit të testeve, duke pasur parasysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksonomisë së Blumit, të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza dhe sinteza. Në çdo gjysmëvjetor përpilohet nga një test vlerësues dhe nga një test i përparimit dhe, në fund të vitit, një test përfundimtar (përmbledhës).

- **Vlerësimi sipas aktivitetit në laboratorin e shkollës**

Në ato shkolla ku ekziston kabineti i fizikës, arsimtari sipas programit do të demonstrojë ose do të kryejë ndonjë matje të ndonjë madhësie ose dukurie fizike. Pikërisht gjatë këtij angazhimi të arsimtarit, disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktivë se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë arsimtarit në procesin e demonstrimit apo të matjes, apo do ta kryejnë në mënyrë të pavarur. Edhe ky aktivitet duhet të vlerësohet.

- **Vlerësimi i punës së pavarur praktike të nxënësve në shkollë dhe në shtëpi**

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga përcjellja e aktivitetit të tyre në punë praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimtari detyra konkrete, të cilat do t'i realizojnë në mënyrë praktike.

Vlerësimi i raportit me shkrim të një pune praktike apo një hulumtimi të pavarur.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Z. Shemsidini, R. Gashi dhe H. Ajazaj, Fizika 6 dhe Fizika 7, Dukagjini, Pejë, 2004.
2. Rasim Bejtullahu, Mustafë Bytyçi, Burim Kamishi dhe Sadik Bekteshi, Fizika 7, *Libri Shkollor*, Prishtinë, 2004.
3. Prof. dr. Ilia Prifti, Fatos Mustafai, dr. Maksim Shimani, Kristaq Piti, Mjeshtër Kërk. dr. Bujar Basha: Fizika 7.
4. Prof. dr. Ilia Prifti, Fatos Mustafai, Kristaq Piti: Fizika 8.

HYRJE

Lënda Kimia 8, paraqet vazhdimësi të lëndës së kimisë të filluar në klasën e 7-të. Në klasën e 8 do të zhvillohen përmbajtjet programore: njehsimet kimike - stekiometria, shpejtësia e reaksioneve kimike, elementet kimike (metalet, jometalet dhe gjysmëmetalet), vetitë dhe komponimet e tyre. Gjithashtu, do të përfshihen përmbajtjet që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit.

QËLLIMET

Nxënësit të:

- Zgjerojnë dhe të thellojnë njohuritë për njehsimet në kimi, shpejtësinë e reaksioneve kimike dhe ekuilibrin (drejtpeshimin) kimik, elementet kimike, vetitë dhe komponimet e tyre.
- Vlerësojnë se kimia si shkencë eksperimentale është pjesë e jetës sonë e cila e ndihmon dhe e përcjell njeriun gjatë tërë jetës, duke e ndihmuar zhvillimin e shoqërisë, shkencës, ekonomisë, kulturës dhe teknologjisë.
- Zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehitë dhe shkathtësitë përmes aktiviteteve të ndryshme, punës eksperimentale dhe qasjeve të ndryshme të hulumtimit të problemeve për punë të pavarur teorike e praktike dhe të krijojnë kulturë për mbrojtjen e mjedisit.
- Të formohen në rrafshin teoriko-praktik si personalitet me qëndrim autonom, kritik dhe me kulturë për bashkëpunim kolegjial të ndërsjelltë me: arsimtarë, prindër dhe komunitetin shkollor dhe jashtëshkollor për avancimin e të menduarit kritik dhe të pavarur të aktivitetit të shkollës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË:

Nxënësit duhet:

Të njohin:

- Konceptin e molit, masës molare dhe vëllimit molar.
- Vetitë e elementeve dhe të komponimeve të tyre.
- Proceset e përfitimit të metaleve, gjysmëmetaleve dhe jometaleve.

Të kuptojnë:

- Teoritë, ligjet dhe metodat shkencore në bazë të të cilave zhvillohen reaksionet kimike.
- Vartësinë e ndërtimit të sistemit periodik në bazë të vetive të elementeve.
- Shpejtësinë e reaksioneve kimike dhe faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve.

Të zbatojnë:

- Njësitë matëse të sistemit SI dhe rregullat gjatë llogaritjeve në kimi.
- Rregullat e Unionit Ndërkombëtar për Kimi të Pastër dhe të Zbatuar (IUPAC) për emërtimin e komponimeve kimike.
- Pajisjet laboratorike, kimikatet, si dhe masat mbrojtëse në rast rreziku.

Të analizojnë:

- Vetitë fizike dhe kimike të elementeve, si dhe të komponimeve të tyre.
- Vetitë e metaleve, gjysmëmetaleve dhe jometaleve.
- Shpejtësinë dhe faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike.

Të sintetizojnë:

- Komponimet e thjeshta kimike (oksidet, acidet, bazat, kripërat etj.).

Të vlerësojnë:

- Rëndësinë e elementeve kimike dhe të komponimeve të tyre për jetë.
- Efektet eventuale negative të disa substancave për mjedisin dhe masat për ruajtjen e mjedisit.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

<i>Kategoritë</i>	<i>Nënkategoritë</i>	<i>Numri i orëve</i>	<i>%</i>
I. Bazat e kimisë	1. Njehsimet kimike-stekiometria	9	
	2. Shpejtësia e reaksioneve kimike dhe ekuilibri (drejtpeshimi) kimik	10	
II. Elementet kimike dhe klasifikimi i tyre	1. Jometalet dhe gjysmëmetalet	20	
	2. Metalet	26	
	3. Mbrojtja e mjedisit	9	

<i>Kategoria</i>	<i>Nënkategoria</i>	<i>Përmbajtja programore</i>	<i>Rezultatet e pritshme</i>	<i>Lidhjet ndërlëndore</i>
I. Bazat e kimisë	I. 1. Njehsimet kimike	<p>I. 1. 1. Masa absolute e atomit, masa atomike relative dhe masa molekulare relative (Llogaritja e masës absolute të atomeve dhe e masave molekulare relative)</p> <p>I. 1. 2. Sasia e substancës-moli (njehsime me molin, masën molare dhe vëllimin molar)</p> <p>I. 1. 3. Pjesëmarrja në përqindje e elementeve në komponim, masa e reaktantëve dhe e produkteve të reaksionit (Llogaritja e pjesëmarrjes së elementeve në komponim e shprehur në përqindje. Llogaritja e masës së reaktantëve dhe e produkteve të reaksionit.</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të njehsojnë masën e vërtetë të atomeve duke shfrytëzuar njësinë e unifikuar të masës, u 2. Të llogarisin masën atomike mesatare të elementeve duke u nisur nga izotopet 3. Të llogarisin masat molekulare relative duke shfrytëzuar të dhënat nga Sistemi periodik i elementeve 4. Të përkufizojnë molin si sasi e substanës dhe të bëjnë njehsime me molin 5. Të zbatojnë lidhjet e molit me numrin e grimcave, masën, masën molare dhe vëllimin molar 6. Të llogarisin pjesëmarrjen e elementeve në komponim e shprehur në përqindje 7. Të shkruajnë barazimet e reaksioneve kimike dhe të llogarisin masën, molet dhe vëllimin e reaktantëve dhe të produkteve të reaksionit kimik 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (llogaritja dhe përdorimi i njësive matëse) ▪ Matematikë (përdorimi i operacioneve matematike për llogaritje kimi) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti).
I. Bazat e kimisë	I. 2. Shpejtësia e reaksioneve	<p>I. 2. 1. Shpejtësia e reaksioneve kimike (Nocioni i shpejtësisë së reaksioneve kimike)</p> <p>I. 2. 2. Faktorët që ndikojnë në</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përshkruajnë nocionin e shpejtësisë së reaksioneve kimike 2. Të zbatojnë metoda të përshtatshme për hulumtimin e shpejtësisë së reaksionit kimik 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (ligjet e elektrolizës) ▪ Informatikë

	kimike dhe drejtpe-shimi kimik	<p>shpejtësinë e reaksioneve kimike (Ndikimi i përqendrimit, i temperaturës dhe i katalizatorëve në shpejtësinë e reaksioneve kimike)</p> <p>I. 2. 3. Drejtëpeshimi kimik (Reaksionet e pakthyeshme dhe të kthyeshme)</p> <p>I. 2. 4. Reaksionet e oksido-reduktimit (Koncepti i oksidimit dhe i reduktimit dhe barazimi i reaksioneve oksido-reduktuese)</p> <p>I. 2. 5. Elektroliza dhe burimet kimike të rrymës elektrike (Procesi i elektrolizës, bateritë)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 3. Të interpretojnë informatat e marra për shpejtësinë e reaksioneve gjatë eksperimenteve kimike 4. Të identifikojnë faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike 5. Të dallojnë reaksionet e pakthyeshme dhe ato të kthyeshme 6. Të dallojnë konceptet oksidim dhe reduktim në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë 7. Të përshkruajnë proceset e oksidimit dhe të reduktimit 8. Të identifikojnë cilat substanca oksidohen dhe cilat reduktohen gjatë reaksioneve oksido-reduktuese 9. Të barazojnë reaksionet e oksido-reduktimit për shembuj të thjeshtë 10. Të përshkruajnë procesin e elektrolizës 11. Të demonstrojnë procesin e elektrolizës e ujit 12. Të identifikojnë burimet kimike të rrymës elektrike-bateritë. 	<p>(shfrytëzimi i informatave nga interneti)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (reaksionet oksidoreduktuese në organizmat e gjallë) ▪ Industri (përdorimi i burimeve kimike të rrymës elektrike)
II. Elementet kimike dhe klasifikimi i tyre	II. 1. Jometalet dhe gjysmëmetalet	<p>II. 1. 1. Klasifikimi i elementeve kimike në Sistemin Periodik të elementeve (Metalet, gjysmëmetalet dhe jometalet)</p> <p>II. 1. 2. Klori</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përshkruajnë natyrën e periodave dhe të grupeve në Sistemin periodik të elementeve 2. Të dallojnë metalet, gjysmëmetalet dhe jometalet sipas vetive të tyre 3. Të përshkruajnë vetitë fizike dhe kimike të 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (përcaktimi i vetive të metaleve dhe jometaleve) ▪ Informatikë

	<p>(Vetitë, përfitimi, komponimet, përdorimi)</p> <p>II. 1. 3. Oksigjeni (Përhapja, vetitë, përfitimi, komponimet)</p> <p>II. 1. 4. Sulfuri (Vetitë, përfitimi, komponimet, përdorimi)</p> <p>II. 1. 5. Azoti (Përhapja, vetitë, përfitimi, komponimet)</p> <p>II. 1. 6. Karboni (Vetitë, përfitimi, komponimet)</p> <p>II. 1. 7. Fosfori (Vetitë, përfitimi, komponimet)</p> <p>II. 1. 8. Silici (Vetitë, përfitimi, komponimet)</p>	<p>klorit</p> <p>4. Të identifikojnë komponimet e klorit dhe përdorimin e tyre</p> <p>5. Të shpjegojnë përhapjen në natyrë, vetitë, komponimet dhe përdorimin e oksigjenit</p> <p>6. Të analizojnë komponimet e oksigjenit</p> <p>7. Të vlerësojnë rëndësinë e oksigjenit për jetë</p> <p>8. Të përshkruajnë vetitë e sulfurit dhe përfitimin e tij</p> <p>9. Të identifikojnë komponimet më të rëndësishme të sulfurit</p> <p>10. Të tregojnë përhapjen e azotit në natyrë dhe vetitë e tij</p> <p>11. Të shkruajnë formulat e komponimeve më të rëndësishme të azotit dhe vetitë e tyre</p> <p>12. Të vlerësojnë rëndësinë e plehërave azotike për zhvillimin e kulturave bujqësore</p> <p>13. Të përshkruajnë vetitë e karbonit dhe përhapjen në natyrë</p> <p>14. Të dallojnë modifikimet alotropike të karbonit</p> <p>15. Të dallojnë komponimet inorganike nga ato organike të karbonit</p> <p>16. Të përshkruajnë komponimet më të rëndësishme inorganike të karbonit</p> <p>17. Të përshkruajnë vetitë, komponimet më të</p>	<p>(shfrytëzimi i informatave nga interneti.)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (rëndësia e elementeve biogjene) ▪ Industri (përdorimi i jometaleve dhe i komponimeve të tyre)
--	--	---	--

			<p>rëndësishme dhe përdorimin e fosforit dhe të komponimeve të tij</p> <p>18. Të përshkruajnë përhapjen në natyrë, vetitë e silicit dhe të silikateve</p> <p>19. Të vlerësojnë rëndësinë e përdorimit të silicit në elektronikë dhe të silikateve në ndërtimtari.</p>	
<p>II. Elementet kimike dhe klasifikimi i tyre</p>	<p>II. 2. Metalet</p>	<p>II. 2.1. Metalet (Përhapja, vetitë e metaleve, përftimi, aliazhet dhe përdorimi)</p> <p>II. 2. 2. Natriumi (Vetitë, përftimi, komponimet)</p> <p>II. 2.3. Magnezi (Përhapja, vetitë, përftimi, komponimet)</p> <p>II. 2. 4. Kalciumi (Vetitë, përftimi, komponimet)</p> <p>II. 2. 5. Hekuri (Përhapja në natyrë, vetitë, përftimi, komponimet dhe zbatimi i tyre)</p> <p>II. 2. 6. Korozioni dhe mbrojtja prej korozionit</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përshkruajnë përhapjen e metaleve dhe të xeheve të tyre në natyrë 2. Të analizojnë vetitë xeheve, të metalave, aliazheve të tyre dhe metodat e përftimit 3. Të dallojnë vetitë e metaleve në bazë të reaktivitetit kimik 4. Të përshkruajnë vetitë fizike dhe kimike të natriumit 5. Të identifikojnë komponimet më të rëndësishme të natriumit dhe përdorimin e tyre 6. Të shpjegojnë përhapjen në natyrë, vetitë, komponimet dhe përdorimin e magnezit dhe të komponimeve të tij 7. Të analizojnë komponimet e magnezit dhe rolin e tyre tek organizmat e gjallë 8. Të përshkruajnë përhapjen në natyrë, vetitë, komponimet dhe përdorimin e kalciumit dhe të komponimeve të tij 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (përcaktimi i vetive të metaleve dhe jometaleve) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti) ▪ Biologji (rëndësia e elementeve biogjene) ▪ Industri (përdorimi i metaleve, aliazheve dhe komponimeve të tyre)

		<p>(Procesi i korozionit dhe masat mbrojtëse ndaj tij)</p> <p>II. 2. 7. Bakri (Përhapja në natyrë, vetitë, përfitimi, komponimet dhe zbatimi i tyre)</p> <p>II. 2. 8. Plumbi (Përhapja në natyrë, vetitë, përfitimi, komponimet dhe zbatimi i tyre)</p> <p>II. 2. 9. Zinku (Përhapja në natyrë, vetitë, përfitimi, komponimet dhe zbatimi i tyre)</p> <p>II. 2.10. Alumini (Përhapja në natyrë, vetitë, përfitimi, komponimet dhe zbatimi i tyre)</p>	<p>9. Të vlerësojnë rëndësinë e kalciumit dhe të mineraleve në ndërtimtari</p> <p>10. Të përshkruajnë rolin e kripërave të kalciumit dhe të magnezit si përbërës të ujërave natyrore</p> <p>11. Të shpjegojnë për përhapjen në natyrë të xeheve të hekurit, metodat për përfitim e hekurit dhe të aliazheve të tij</p> <p>12. Të përshkruajnë vetitë e hekurit dhe komponimet më të rëndësishme të tij.</p> <p>13. Të vlerësojnë rëndësinë e aliazheve të hekurit në industri dhe jetën e përditshme</p> <p>14. Të identifikojnë procesin e korozionit dhe dëmet e shkaktuara</p> <p>15. Të gjykojnë për masat mbrojtëse që duhet ndërmarrë për të eliminuar dhe kufizuar korozionin</p> <p>16. Të tregojnë përhapjen e bakrit në natyrë, përfitim, aliazhet, komponimet dhe rëndësinë e tyre</p> <p>17. Të përshkruajnë përhapjen e plumbit, vetitë, përfitim, aliazhet, komponimet dhe përdorimin e tyre</p> <p>18. Të vlerësojnë rëndësinë e plumbit dhe të aliazheve të tij në industri</p> <p>19. Të përshkruajnë përhapjen e zinkut, përfitim, vetitë, aliazhet, komponimet dhe përdorimin e tyre</p> <p>20. Të përshkruajnë përhapjen e aluminit,</p>	<p>▪ Metalurgji (përfitimi i metaleve)</p>
--	--	--	--	---

			përfitim, vetitë, aliazhet, komponimet dhe përdorimin e tyre.	
II. Elementet kimike dhe klasifikimi i tyre	II. 3. Mbrojtja e mjedisit	<p>III. 3. 1. Ndotja e ajrit (Ndotja dhe pasojat e ndotjes së ajrit)</p> <p>III. 3. 2. Shirat acidike (Ndikimi i tyre në bimë dhe në monumente kulturore)</p> <p>III. 3. 3. Ndotja e ujërave dhe pastrimi i ujërave të ndotura (Ndotësit dhe pasojat e ndotjes së ujit, pastrimi i ujërave të ndotura)</p> <p>III. 3. 4. Ndotja e tokës dhe mbrojtja e saj (Ndotja e tokës (truallit) dhe ndikimi në ekosistem)</p> <p>III. 3. 5. Trajtimi i mbeturinave (Krijimi i mbeturinave dhe metodat e trajtimit)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dallojë ajrin e ndotur nga ajri i pastër 2. Të identifikojnë ndotësit dhe burimet kryesore të ndotjes së ajrit. 3. Të numërojnë shkaktarët kryesorë të shirave acidike. 4. Të analizojnë ndotësit e ujit dhe metodat e pastrimit të ujërave. 5. Të identifikojnë ndotësit e tokës dhe ndikimin e tyre në organizmat e gjallë. 6. Të përshkruajnë metodat për trajtimin e mbeturinave. 7. Të vlerësojnë ndikimin e ndotësve të ajrit, të ujit dhe të tokës në cilësinë e jetës së njeriut. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Informatikë (Shfrytëzimi i informatave nga interneti.) ▪ Biologji (Ndikimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në ekosistem) ▪ Industri (Metodat për pastrim nga ndotja dhe procesi i reciklimit të mbeturinave)

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe programit të kimisë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike siç janë: vizatime, diagrame, modele, grafikë, kimikate, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore – kompjuter, internet etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxisin dinamikën e orës mësimore, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, të shprehive, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave të kimisë e veçanërisht të atyre që u nevojiten për zgjedhjen e problemeve të përditshme.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma të punës dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejt (shpjegimi, sqarimi, ushtrimet praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie e tërthortë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Konstruktivizmi dhe mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vëzhgimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritshme.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve përfshin këto kategori vlerësimi:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ, i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e pëgjithshëm të të nxënësve (përgjigjet me gojë, projektet, punimet seminarike, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe provimeve etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta vlerësimi dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një semestër ose gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimi i shërbejnë mësimitdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimit;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojnë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojnë për përmirësimin e mësimitdhënies mbështetur në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimitdhënien dhe mësimitnxënien e planit dhe programit të kimisë, mësimitdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi:

- 1) Laboratori (kabineti) i kimisë ose laborator mobil.
- 2) Teksti i kimisë, doracak për mësimitdhënësin, praktikume, fletore pune dhe literaturë tjetër të ngjashme në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja botërore.
- 3) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 4) Sistem periodik të elementeve, fotografi, modele, skema, diagrame, makete, koleksionarë mineralesh.
- 5) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 6) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 7) FJALORI I KIMISË, SH.B. "8 Nëntori",Tiranë.
- 8) Bardhyl Musai, METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, Tiranë, 2003.
- 9) Grup autorësh, METODAT E MËSIMDHËNIES, (Manual për mësuesit e rinj).

10) Literatura tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimit dhe të mësimit.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

HYRJE

Me lëndën e historisë në këtë klasë pretendohet të bëhet njohja dhe përgatitja e nxënësve për të kuptuar rrjedhojat e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore nga Kongresi i Vjenës (1814) deri në fund të Luftës së Parë Botërore (1918).

Përmes lëndës së historisë pretendohet të krijohen mundësi për zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të nxënësve si nga aspekti human, ekonomik, shoqëror, kulturorë, politikë etj.

Lënda e Historisë synon të zhvillojë të menduarit kritik, analitik, vlerësues, krahasues si dhe angazhimin për hulumtimin dhe përdorimin e burimeve dhe të dhënave historike, duke dalluar rëndësinë e tyre. Këto përpjeke duhet të jenë në përputhje me mundësitë, aftësitë psiko-fizike dhe afinitetet e nxënësve.

QËLLIMET

Ky programi mësimor ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të njohur dhe kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore prej Kongresit të Vjenës e deri në përfundim të Luftës së Parë Botërore.
- Zhvillimin e aftësive për të njohur dhe kuptuar mënyrat e jetesës, personalitetet historike, vendet dhe institucionet shoqërore e shtetërore, besimet, të arriturat ekonomike, shkencore, kulturore etj.
- Zhvillimin e shkathtësive dhe shprehive të nevojshme për njohjen, kuptimin, përpunimin dhe zbatimin e të dhënave të ndryshme historike në kohë dhe në rrethana të caktuara.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të njohin

- Domethëniet e termave dhe shprehjeve historike të Kohës së Re dhe Kohës Bashkëkohore

Të kuptojnë

- Veçoritë kryesore të zhvillimeve historike të këtyre periudhave
- Konceptet dhe parimet e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, arsimore, shkencore, religjioze, etj.

Të zbatojnë

- Informacionet historike për zgjidhjen e situatave të ndryshme që paraqiten në shoqëri.
- Format e mundshme për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në shoqëri.

Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera

- Të vlerësojnë dhe të çmojnë të arriturat e shoqërisë njerëzore gjatë këtyre periudhave.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri.
- Për ruajtjen dhe kujdesin, për trashëgiminë arkeologjike, monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj.

HISTORI Kl. VIII 2 x 37 = 74 orë në vit (54 orë zhvillim, 4 orë në dispozicion dhe 16 orë përsëritje)

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Nërlidhjet programore
IV. KOHA E RE	3. Evropa gjatë Kohës së Re	<i>Nxënësit duhet të mësojnë për:</i> Evropa në gjysmën e parë të shekullit XIX Ngjarjet kryesore politike, shoqërore dhe ekonomike në Evropë në gjysmën e parë të shekullit XIX; Kongresi i Vjenës, revolucionet e vitit 1848 në Evropë etj. (3 orë)	<i>Nxënësit duhet:</i> Të kuptojnë zhvillimet shoqërore, ekonomike, politike, etj.; në Evropë në gjysmën e parë të shekullit XIX. Të dallojnë veçoritë e secilit popull dhe shtet në këtë periudhë. Të identifikojnë personalitetet kryesore të kësaj periudhe.	<i>Me:</i> Gjeografinë, edukatën qytetare, muzikën etj.
IV. KOHA E RE	6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika	Kultura në Evropë Zhvillimi i kulturës në Evropë në shekullin XIX. (1 orë)	Të njohin zhvillimet kulturore evropiane të shekullit XIX. Të krahasojnë këto zhvillime me ato më të hershme.	Gjeografinë, letërsinë, artin, muzikën etj.
IV. KOHA E RE	3. Evropa gjatë Kohës së Re	Bashkimet kombëtare, revolucionet industriale dhe ndryshimet shoqërore Bashkimi i Gjermanisë, Bashkimi i Italisë	Të kuptojnë rrjedhat e procesit të bashkimit kombëtar në Evropë. Të nxjerrin përfundime për rëndësinë e revolucionit	Gjeografinë, letërsinë, teknologjinë, fizikën, kiminë etj.

		Revolucioni industrial dhe rëndësia e tij. Ndryshimet e rëndësishme në jetën shoqërore. (4 orë)	industrial dhe për reflektimin e këtyre të arriturave në zhvillimet e përgjithshme shoqërore. Të identifikojnë personalitetet kryesore dhe veprimtarinë e tyre gjatë kësaj periudhe.	
	5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë Kohës së Re	SHBA Lufta Civile në SHBA dhe SHBA-të pas kësaj lufte. (2 orë)	Të kuptojnë rrjedhat e proceseve në SHBA gjatë asaj kohe.	Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare etj.
	6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika	Kultura, arti Zhvillimi i kulturës dhe i artit në shekullin XIX. (1 orë)	Të dallojnë veprimtarinë dhe përfaqësuesit kryesorë të romantizmit në kulturë dhe në art. Të vlerësojnë rolin e tyre në rrjedhat e shoqërisë	Letërsinë, muzikën, artin etj.
IV. KOHA E RE	13. Evropa gjatë Kohës së Re	Evropa në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX Britania e Madhe, Gjermania, Franca Italia, Austro-Hungaria dhe Rusia gjatë asaj kohe. (6 orë)	Të njohin zhvillimet kryesore të vendeve evropiane në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shek. XX. Të identifikojnë veçoritë dhe personalitetet kryesore që lanë gjurmë në këtë periudhë.	Gjeografinë, edukatën qytetare,etj.

<p>IV. KOHA E RE</p>	<p>5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë Kohës së Re</p>	<p>SHBA, Afrika , Azia dhe Amerika Latine në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX SHBA në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Veçoritë kryesore të zhvillimit në Azi, Afrikë dhe Amerikën Latine. (2 orë)</p>	<p>Të kuptojnë veçoritë kryesore të zhvillimit të SHBA-ve, Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine. Të identifikojnë termat dhe konceptet shtet federal, trust, monopol etj.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë etj.</p>
<p>IV. KOHA E RE</p>	<p>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</p>	<p>Shkenca dhe teknika Zhvillimi i shkencës dhe i teknikës në botë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. (1 orë)</p>	<p>Të kuptojnë rrjedhat dhe përparësitë e zhvillimit të shkencës dhe të teknikës në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Të nxjerrin përfundime për rëndësinë e madhe të të arriturave në shkencë dhe në teknikë.</p>	<p>Biologjinë, kiminë, fizikën, teknologjinë, etj.</p>
	<p>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë Kohës së Re</p>	<p>Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë Kohës së Re Tanzimati (Reformat) në Perandorinë Osmane. Krizja Lindore dhe Traktati i</p>	<p>Të kuptojnë kronologjinë e ngjarjeve dhe rrethanat ekonomike, shoqërore e politike në Perandorinë Osmane dhe Ballkan gjatë</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë, artin etj.</p>

		<p>Shën-Stefanit. Kongresi i Berlinit. Vendet e Ballkanit gjatë kësaj periudhe (Greqia, Serbia, Mali i Zi, Bullgaria) Fillet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Formimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Përpyekjet e Lidhjes së Prizrenit për formimin e shtetit shqiptar. Lidhja e Pejës. Personalitetet e njohura. Zhvillimi i qyteteve shqiptare. (13 orë)</p>	<p>kësaj periudhe.</p> <p>Të shpjegojnë arsyet e fillimit të Krizës Lindore dhe reflektimin e saj për Ballkanin dhe shqiptarët.</p> <p>Të vlerësojnë rolin e personaliteteve më të shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.</p> <p>Të nxjerrin përfundime për rëndësi- në e zhvillimit të qyteteve shqiptare dhe të zhvillimit ekonomik.</p>	
IV. KOHA E RE	6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika	<p>Arsimi dhe kultura Arsimi dhe kultura në fund të shekullit XIX. Shoqëritë patriotike brenda dhe jashtë trojeve shqiptare. Monumentet kulturo-historike. (3 orë)</p>	<p>Të analizojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat u zhvillua arsimi dhe kultura në trojet shqiptare. Të njohen me shoqëritë patriotike që vepruan brenda dhe jashtë atdheut, si dhe me monumentet kulturo - historike të kësaj periudhe.</p>	Gjeografinë, letërsinë etj.

<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>1. Bota në fillim të shekullit XX</p>	<p>Ballkani dhe shqiptarët në fillim të shekullit XX Shqiptarët dhe Revolucioni xhonturk. Kryengritjet shqiptare kundër sundimit osman 1910-1912. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Qeveria e Ismail Qemalit dhe veprimtaria e saj. Personalitetet e shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Luftërat Ballkanike. Vendimet e Konferencës së Londrës për Ballkanin. Lufta e shqiptarëve për çlirim dhe bashkim kombëtar. Shqipëria gjatë kohës së Vilhem Vedit.</p> <p>(9 orë)</p>	<p>Të kuptojnë veçoritë kryesore të fazës së katërt të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, shpalljen e pavarësisë, Luftërat Ballkanike, Konferencën e Londrës dhe periudhën e qeverisjes së princ Vilhelm Vedit.</p> <p>Të analizojnë rezultatet e kryengritjeve shqiptare për çlirim kombëtar si dhe shkaqet e pasojat e Luftërave Ballkanike dhe të Konferencës së Londrës për çështjen shqiptare.</p> <p>Të nxjerrin përfundime për këtë periudhë historike.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, artin etj.</p>
<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>5. Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë gjatë</p>	<p>Arsimi, kultura Zhvillimi i arsimit dhe i kulturës 1908-1912. Letërsia dhe artet.</p>	<p>Të analizojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat u zhvillua arsimi dhe kultura kombëtare. Të vlerësojnë të arriturat në</p>	<p>Letërsinë, artin, muzikën etj.</p>

	shekullit XX	(2 orë)	arsim dhe në kulturë gjatë kësaj kohe.	
V. KOHA BASHKËKOHORE	1. Bota në fillim të shekullit XX	Lufta e Parë Botërore Shkaqet e fillimit të luftës. Lufta e Parë Botërore 1914-1918 Revolucioni Socialist i Tetorit në Rusi. Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore. Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore. Pasojat e Luftës së Parë Botërore. (7 orë)	Të kuptojnë rrethanat e përgjithshme dhe shkaqet e fillimit të luftës, rrjedhat dhe pasojat e saj. Të dallojnë veçoritë e Revolucionit Socialist. Të njohin pozitën dhe rolin e shqiptarëve gjatë kësaj periudhe. Të analizojnë raportet e forcave të blloqeve ndërluftuese. Të nxjerrin përfundime për pasojat e luftës.	Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë, etj.

Vërejtje: 4 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodologjia e mësimdhënies përcakton suksesin e realizimit të qëllimeve dhe objektivave që mësimdhënësi ia paracakton vetes në bazë të përmbajtjeve programore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së vetë nxënësve. Prandaj, gjatë një ore mësimore, mësimdhënësi mund të përdorë disa forma, teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra-tjetrën në mënyrë që të arrijë rezultate optimale gjatë procesit mësimor. Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore me nxënësin në qendër sugjerohen, metoda, forma dhe teknika të tilla si:

Format kryesore të organizimit të procesit mësimor janë:

Puna me gjithë klasën,

Puna me grupe (të mëdha ose të vogla)

Puna me çifte

Puna individuale

Metodat:

E mësimdhënies -(kallëzimi, shpjegimi, ligjërata, biseda, demonstrimi etj.)

E të mësuarit - është metodë e punës së përbashkët e mësimdhënësit dhe nxënësve dhe përdoret për arritjen e qëllimeve, synimeve, qëllimeve, objektivave etj,

E të nxënit - (vrojtimi i pavarur, ushtrimet, diskutimet, debatet, shfrytëzimi i literaturës, shkëmbimi i mendimeve etj.)

Kërkimore - është metodë që mundëson të bëhen kërkime historike përmes burimeve dhe analizave lidhur me saktësinë dhe interpretimin e fakteve të gjetura.

Teknikat:

Ekziston një numër i madh teknikash të mësimdhënies dhe të nxënies. Këtu sugjerohen vetëm disa sosh.

- **Brainstormingu** (“stuhi, mendimesh“, **gjenerim idesh**)- është teknikë efektive që më tepër përdoret në fillim të orës mësimore.

- **Klasteri (grumbulli apo pema e mendimeve)** - nxit nxënësit për të menduar rreth një teme të caktuar. Rëndon shërben për të krijuar lidhje midis fakteve.

- **Insert-i** - (është sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe lexim të efektshëm). Kjo teknikë përdoret në pjesën kryesore dhe është efektive sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që lexon.

- **Pesëvargëshi** – është teknikë e veçantë e cila ka pesë vargje që kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet, të cilat përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës.

- **Xhigsou (Ndërthurja)** – është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga ana e të gjithë nxënësve, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Teknika tjera janë: *ditari dypjesësh, di dua të dijë mësova, ese 5 dhe 10, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit shkrimi i lirë etj.*

Historia gojore është gjithashtu një nga mënyrat bashkëkohore të mësuarit të lëndës së historisë.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate të dëshiruara. Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses muzetë, galeritë, bibliotekat, arkivat, ekskursionet në vendet dhe monumentet kulturo-historike etj.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëheqës.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe u shërben disa qëllimeve të ndryshme.

Ndër qëllimet kryesore të vlerësimit janë:

1. Të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve.
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor.
3. T'i motivojë nxënësit.

4. Të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuar.
5. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Tipat e vlerësimit

Ekzistojnë tipa të larmishëm vlerësimi si:

- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.
- **Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe te nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.
- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotuarat paraprake dhe objektivat e parashikuar.
- **Vetvlerësimi** është proces i mbledhjes, analizimit, interpretimit të informatave dhe veprimtarisë që nxënësi e bënë vetë me anë të ndonjë mjeti vlerësues.
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies p.sh. pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.
- **Vlerësimi në bazë të kriterëve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara p.sh., krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit që të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë në përmirësimin e tyre.
- **Vlerësimi formues dhe diagnostikues** nuk vlerëson me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikon punën e tij.
- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkolles (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** mbështetet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.

- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe mbështetet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi në proces** mbështetet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- *Kontrolli i rëndomtë i veprimtarive në klasë*
- *Detyrat e shtëpisë*
- *Testet*

- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.

- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojmë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherësh mund të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

Format e testeve janë:

- Me gojë
- Me shkrim
- Përmes paraqitjes grafike etj.

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anët negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj. Gjatë zbatimit të testimit, sistemi i poentimit zgjidhet nga vetë mësimdhënësi.

Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari të tjera, p.sh.,

- Vlerësimi i eseve
- Vlerësimi me dosje
- Vetëvlerësimi etj.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Prishtinë, 1997.
2. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Tiranë, 1995.
3. Bardhyl Musai, Psikologjia e Edukimit, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë, 1999.
1. Bardhyl Musai, Metodologjia e Mësimdhënies, Tiranë 2003.
5. Grup autorësh, Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët për të ndërtuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000, botues: EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë 2003.
6. MASHT, Plani dhe programi mësimor 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003.
7. MASHT, Plani dhe programi mësimor 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
8. Historia e Popullit Shqiptar I,II, Tiranë 2001.
9. Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, Historia 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
10. Isa Bicaj, Arbër Salihu, Historia 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
11. Mikel Pjetrushaj, Atlas historik i botës, Shtëpia Botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001.

BURIMET NË INTERNET

1. www.dadalos.org
2. www.historyplace.com
3. www.see-educoop.net
4. www.eurocliohistory.org
5. www.euroclio.net

HYRJE

Gjeografia e kontinenteve pa Evropën ka për objekt studimi hapësirën e kontinenteve të tjera në tërësi, regjionet e tyre dhe shtetet tipike në veçanti. Njohuritë e nxëna do të ndihmojnë kuptimin e pozitës gjeografike të kontinenteve, regjioneve dhe shteteve, rolin e kushteve dhe resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik dhe jetën e njerëzve, dallimin e specifikave populative, kulturore e politike të lidhura për veçoritë hapësinore të regjioneve e vendeve ku ata jetojnë. Gjeografia e kontinenteve ndihmon të kuptuarit e ndërlidhjeve mes shoqërisë e natyrës, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e saj, bashkëpunimin mes popujve e komuniteteve me përkatësi të ndryshme etnike, fetare, politike, kulturore e gjinore. Nga regjionet dhe vendet e ndryshme të kontinenteve të tjera ka shumë shembuj prej të cilëve mund të mësohet si (nuk) duhet të veprohet, për t'i zbatuar ato përvoja në vendin tonë.

QËLLIMET

Qëllimi i të mësuarit të gjeografisë së kontinenteve bazohet në:

1. Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të **njohur** pozitën gjeografike, veçoritë natyrore e humane të kontinenteve, regjioneve e vendeve tipike dhe ndikimin e kushteve natyrore e faktorëve shoqëror në mjedisin e tyre.
2. Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të **kuptuar** rolin e pozitës gjeografike, veçorive të natyrës e shoqërisë, ndikimin e kushteve në aktivitetin njerëzor, sfidat dhe perspektivat e ndërvarësisë regjionale.

3. Zhvillimin e **shkathësive** dhe të **shprehivë** të nevojshme për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave të ndryshme në situata konkrete.
4. Zhvillimin e **gatishmërisë** për të **përdorur drejt** dhe me **përgjegjësi** njohuritë, shkathësitë dhe shprehitë e fituara nga mësimi i gjeografisë.
5. Zhvillimi i **qëndrimeve dhe i vlerave** për laramaninë e veçorive natyrore, kushteve të ndryshme të jetës dhe të veprimtarive njerëzore.
6. Zhvillimin e aftësive për **respektimin** e të drejtave njerëzore për gjithë popujt pa marrë parasysh përkatsinë etnike, fetare, gjuhësore, gjinore dhe angazhimin për të kërkuar zgjidhje të problemeve lokale, regjionale e globale.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE TË VEÇANTË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

➤ Të njohë:

- Faktet dhe konceptet për veçoritë natyrore dhe humane të kontinenteve;
- Karakteristikat themelore natyrore dhe humane të kontinenteve, regjioneve dhe shteteve.

➤ Të kuptojë:

- Specifikat gjeografike të kontinenteve, karakteristikat natyrore, sociale, ekonomike dhe politike;
- Ngjashmëritë dhe dallimet e veçorive natyrore, humane mes kontinenteve, regjioneve dhe shteteve tipike.

➤ Të zbatojë:

- Grafikonet, diagrame, modele, harta etj. për elementet relievo, klimatike, hidrografike, shpërndarjen, lëvizjen dhe strukturat e popullsisë dhe veprimtaritë ekonomike;
- Të përdorë të dhënat verbale sasiore dhe simbolike nga teksti, fotografitë, hartat, grafikonet, tabelat, diagramet etj.

➤ **Të analizojë:**

- Rëndësinë e veçorive natyrore dhe humane të kontinenteve në zhvillimin shoqëror e ekonomik;
- Ndikimin e kushteve natyrore dhe faktorëve shoqërorë në zhvillimin ekonomik të kontinenteve, regjioneve e shteteve tipike.

➤ **Të vlerësojë:**

- Rolin e veçorive natyrore dhe humane të kontinenteve, regjioneve dhe shteteve tipike;
- Shkaqet e vërteta të dukurive fizike dhe humane të kontinenteve si: ngrohjen globale, problemin e ujit, të erozionit, të ndotjes, të rritjes së shpejtë të popullsisë, problemin e refugjatëve, zhvillimin e pabarabartë ekonomik të kontinenteve, regjioneve dhe shteteve etj.

➤ **Të zhvillojë qendrimet dhe vlerat:**

- Për llojllojshmërinë e veçorive natyrore, të kushteve të ndryshme të jetesës dhe veprimtarive njerëzore;
- Për kuptimin e sjelljeve personale (për të qenë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershem, i vullnetshëm, kritik etj.).

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

Kategoria	Nënkate- goria	Tërsitë mësimore	Nr. i orëve	Gjithsej
Regjioni	Azia	Vështrim i përgjithshëm për kontinentin e Azisë dhe ndarja regjionale	3+1	
		Azia Jugperëndimore - Veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike, shtetet e Azisë Jugperëndimore (Turqia, Lindja e Afërt).	4+1	
		Azia Jugore - Karakteristikat e përgjithshme dhe veçoritë dalluese natyrore, populatave dhe ekonomike. Shtetet e Azisë Jugore-India dhe Pakistani	3+1	
		Azia Juglindore - Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike-shtetet e Azisë Juglindore-Indonezia, Malezia, Singapuri	2+1	
		Azia Lindore - Lindja e Largme. Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike. Shtetet e Azisë Lindore-Kina, Japonia.	4+1	16+5
Regjioni	Afrika	Afrika - Karakteristikat e Përgjithshme për kontinentin e Afrikës, ndarja regjionale	3+1	
		Afrika Veriore - Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike. - Shtetet e Afrikës Veriore: Egjipti,	3+1	
		Afrika Sudaneze - Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike, Sudani.	1+0	
		Afrika Perëndimore - Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike. Shtetet e Afrikës Perëndimore- Nigeria	1+0	
		Afrika Qendrore Ekuatoriale – Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike. Shtetet e Afrikës Qendrore Ekuatoriale	1+0	
		Afrika Lindore - Tiparet natyrore, populatave dhe ekonomike. Shtetet e Afrikës Lindore. Kenia	1+1	
		Afrika Jugore - Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike. -Shtetet e Afrikës Jugore, Republika Jugoafrikane, epiqendra e rajonit.	2+1	12+4

	Amerika	Amerika -Karakteristikat e përgjithshme, veçoritë natyrore, populative, ekonomiko-politike dhe ndarja regjionale.	3+1	
		-Amerika Veriore. Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populative dhe ekonomike. Shtetet e Amerikës Veriore, SHBA dhe Kanadaja.	6+2	
		Amerika e Mesme. Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populative dhe ekonomike-shoqërore. Meksika.	2+1	
		Amerika Jugore. Karakteristikat e përgjithshme natyrore, populative dhe ekonomike. Shtetet tipike: Brazili, Kili dhe Argjentina	7+2	18 + 6
	Australia dhe Oqeania	Australia me Oqeani. Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, zbulimi dhe popullimi, veçoritë ekonomike dhe regjionet e Australisë.	5+2	5 + 2
	Krahinat Polare	Karakteristikat e përgjithshme natyrore të krahinave Polare.	1+1	1 + 1
		Gjithsej-mësim+përsëritje+ushtrime	52+18	52 + 18
		Vlerësimi i njohurive	4	
		Orë në dispozicion	0	
		Gjithsej orë	74	

Kategoria	Nënkategoria	Numri i orëve	%
Regjioni	Azia	16+5	28.4
	Afrika	12+4	21.6
	Amerika	18+6	32.4
	Australia me Oqeani	5 + 2	9.5
	Krahinat polare	1+ 1	2.7
	Gjithsej (mësim+përsëritje+ushtrime)	52+18	94.6%

Kategoria	Nënkatëgoria	Tërësitë mësimore	Rezultatet e pritshme	Lidhjet ndërlëndore
Regjioni	Azia	<p>Azia e përgjithshme, pozita, madhësia, përkufizimi i kontinentit të Azisë.</p> <p>- Veçoritë seizmike relievo, klimatike, hidrografike dhe biogeografike.</p> <p>- Karakteristikat demografike, kulturore, ekonomike dhe politike.</p>	<p>- Nxënësi t'i përkufizojë kufijtë e Azisë ndaj kontinenteve të tjera dhe të tregojë në përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike.</p> <p>Të bëjë krahasimin nga madhësia e hapësirës me kontinentet e tjera.</p> <p>- T'i dallojë zonat seizmike në Azi.</p> <p>- T'i identifikojë në hartë malet kryesore, rrafshlartat, ultësirat, luginat e mëdha të lumenjve, gadishujt dhe ishuj.</p> <p>- Të shpjegojë rolin e hapësirës së madhe, ndikimin e deteve dhe të oqeanëve në klimë, ndikimin e erërave monsunike, pasurinë në ujëra dhe rrjetin hidrografik.</p> <p>- Të dallojë shtrirjen e brezave klimatike dhe formacionet bimore.</p> <p>- T'i dallojë nga fotografitë tajgen, stepen, makjet, savanet, xhunglat dhe t'i emërtojë kafshët e egra që jetojnë në regjionet e Azisë.</p> <p>- T'i identifikojë dhe t'i tregojë pasuritë kryesore minerale dhe burimet energjetike të Azisë dhe t'i shënojnë në hartën mece ato.</p> <p>- T'i dallojë rajonet kryesore të përqendrimit të popullsisë në Azi dhe t'i tregojë shkaqet e tyre</p> <p>- Të komentojë rritjen e popullsisë së Azisë nga tabela e grafikoni dhe hartën e dendësisë.</p> <p>- Të dallojë racat dhe popujt më të mëdhenj në Azi.</p> <p>- T'a plotësojë hartën e punës me qytete më të mëdha të Azisë dhe ta komentojë atë.</p> <p>- Të evidencojë fuqitë e mëdha që e kolonializuan Azinë në shekullin XIX.</p> <p>Të identifikojë ndryshimet kryesore në hartën politike të Azisë pas Luftës së Dytë Botërore.</p> <p>- Të dallojë grupimet kryesore politike dhe ekonomike në Azi, veprimtaritë kryesore ekonomike dhe rajonet tipike gjeografike të Azisë.</p>	<p>- T'i ndërlidhë njohuritë gjeografike dhe historike, gjeologjike, geomorfologjike, klimatike, hidrografike, biogeografike, demografike, ekonomike dhe politike.</p>

Regjioni	Azia	<p>Azia Jugperëndimore pozita gjeografike-mesdhetare, shtrirja territoriale</p> <p>- Veçoritë seizmike relievore, klimatike, hidrografike dhe biogjeografike.</p> <p>- Veçoritë popullore, kulturore, ekonomike dhe politike</p> <p>(Lindja e Afërt dhe e Mesme) Turqia, Irani dhe Arabia Saudite.</p>	<p>- Të shpjegojë rolin e pozitës gjeografike të Azisë Jug perëndimore dhe të vlerësojë rëndësinë e saj në Azi dhe në botë.</p> <p>Të dallojë veçoritë kryesore të relievit, klimës, hidrografisë dhe botës bimore e shtazore, duke analizuar rëndësinë e tyre për jetën dhe veprimtaritë e njerëzve.</p> <p>- Të gjenden në hartë sistemet malore, fushat, rrafshlartat, shkretëtirat dhe luginat lumore më të njohura dhe të arsyetojë pse rreth Mesdheut dhe në Gadishullin e Azisë së Vogël ka tërmete.</p> <p>- Të analizojë dhe të komentojë klimogramet për vendet e Azisë Jugperëndimore dhe të arsyetojë rrjetin e varfër lumor, sasinë e vogël të ujit gjatë verës dhe mungesën e liqeneve.</p> <p>- Të tregojë veçoritë e ujit të Detit Mesdhe dhe rolin e tyre në ekonomi e turizëm.</p> <p>- Të shënojë në hartën e punës popujt që jetojnë në vendet e Azisë Jugperëndimore dhe të komentojë harta e dendësisë së popullsisë.</p> <p>- Të gjenden në hartë qytetet më të njohura kulturore dhe religjioze të Azisë Jugperëndimore dhe të identifikohen zonat turistike.</p> <p>- Të identifikojë burimet kryesore energjetike dhe pasuritë minerare dhe degët kryesore të ekonomisë.</p> <p>- Të dallojë shtetet e pasura me naftë dhe të argumentojë rolin e naftës në zhvillimin ekonomik dhe jetën e njerëzve.</p> <p>- Të dallojë ngjashmëritë dhe specifikat natyrore, popullore, kulturore, ekonomike dhe politike të Turqisë, Iranit dhe Arabisë Saudite.</p>	<p>- Shpjegimi i veçorive natyrore, popullore, ekonomike dhe politike të regjionit të Azisë Jugperëndimore është e nevojshme njohja e gjeografisë, gjeologjisë, biogjeografisë, demografisë, ekonomisë, sociologjisë, politikës në regjionet në fjalë.</p>
Regjioni	Azia	<p>Azia Jugore</p> <p>- Pozita gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme natyrore,</p>	<p>- Të shpjegojë rolin e pozitës gjeografike ndaj regjioneve të tjera dhe në hartë të gjejë ishujt, gjiret dhe portet kryesore të Azisë Jugore.</p> <p>- T'i gjejë në hartë vargmalet, mallet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.</p> <p>- Të dallojë dhe të arsyetojë tipat e klimës mes pjesëve veriore dhe</p>	<p>- Për shpjegimin e veçorive natyrore, demografike, ekonomike e</p>

		<p>popullative, ekonomike dhe politike.</p> <p>- Shtetet e Azisë Jugore: India dhe Pakistani</p>	<p>jugperëndimore e jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Azisë Jugore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - T'i gjejë në hartë lumenjtë më të rëndësishëm dhe t'i përshkruajë veçoritë specifike të tyre. - T'i gjejë në hartë detet dhe gjiret që i lagin brigjet e këtij nënkontinenti. - Të tregojë me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të qymyrit, hekurit, bakrit, zinkut në këtë regjion. - T'i radhitë popujtë e Azisë Jugore sipas numrit të popullsisë, dendësisë, shtimit natyror dhe t'i shënojë qyetet më të mëdha të këtij regjioni. - T'i evidencojë karakteristikat kryesore të popullsisë dhe të ekonomisë së Azisë Jugore. - Të tregojë faktorët kryesorë që ndikuan në prapambeturinë ekonomike e shoqërore të këtyre vendeve. - Të tregojë specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike të shtetit të Indisë dhe Pakistanit, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. 	<p>politike të Azisë Jugore nevojitet njohuri solide gjeografike, gjeologjike, biogjeografike, demografike, ekonomike dhe politike.</p>
Regjioni	Azia	<p>Azia Juglindore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita skajore gjeografike me lidhje të mira. - Veçoritë karakteristike të relievit, klimës, hidrografisë, vegjetacionit - Tiparet etnike, kulturore e demografike të popujve në Azinë Juglindore 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të përkufizojë regjionin dhe t'i identifikojë gadishujt, ishujt dhe shtetet që e përbëjnë këtë regjion dhe t'i gjejë ato në hartë. - Të përcaktohet ndikimi dhe rëndësia e deteve në këtë regjion. - Të gjenden në hartë sistemet malore, ultësirat e mëdha pjellore, lumenjtë dhe luginat lumore më të njohura dhe të arsyetojë pse nëpër ishujtë e Indokinës ndodhin tërmete e vullkane. - Të dallojë tipat e klimës përmes klimogrameve dhe t'i përshkruajë vetitë e tyre. - Të dijë se çfarë bimësie ka ky regjion dhe cilat kafshë të egra jetojnë aty. - T'i identifikojë veçoritë e përbërjes etnike dhe fetare të popullsisë së Azisë Juglindore. -Të gjejë në hartë qyetet më të njohura të Azisë Jug lindore. 	<p>- Për t'i shpjeguar karakteristikat natyrore, popullative, ekonomike e politike të regjionit të Azisë Juglindore nevojitet ndërlidhja e njohurive gjeografike, gjeologjike,</p>

		<ul style="list-style-type: none"> - Niveli i zhvillimit ekonomik dhe struktura e ekonomisë në përputhje me kushtet natyrore. - Shtetet e Azisë Juglindore: Indonezia, Malezia, Singapuri 	<ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë produktet kryesore bujqësore dhe industriale me të cilat njihen në tregun botëror. - Të përkufizohen dhe të dallohen specifikat natyrore, popullative, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të shteteve të Azisë Juglindore- Indonezisë, Malajzisë dhe Singapurit. 	demografike, kulturore e politike.
Regjioni	Azia	<p>Azia Lindore-</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike. Viset perëndimore të izoluar dhe pak të banuara. - Viset lindore me dalje në Oqeanin Paqësor. Pjesa kontinentale dhe ishullore. - Veçoritë karakteristike të relievit, klimës, hidrografisë dhe vegjetacioni i gjallë, pasuri në qymyr, hekur, naftë, plumb, zink, bakër, boksite, kallaj etj. - Regjion i banuar me racë homogjene 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të përkufizojë regjionin dhe t'i identifikojë shtetet që e përbëjnë këtë regjion. - Të shpjegojë rolin e pozitës gjeografike dhe të evidencojë veçoritë kryesore të pozitës gjeografike. - Të krahasojë viset perëndimore dhe lindore, kontinentale dhe ishullore nga relievi, klima dhe hidrografia. - Të shënojë në hartën e punës malet më të njohura, rrafshlartat, stepat e shkretëtirat, fushat dhe luginat lumore, lumenjtë më të njohur, ishujt në Oqeanin Paqësor të krijuar me aktivitetet vullkanike. - Të dallojë tiparet e klimës dhe dallimet e saj nga deti jugor kinez deri te stepat mongole. - Të tregojë rëndësinë e lumenjve të gjatë në pjesën kontinentale dhe atyre të shkurtër në pjesën ishullore. - Të dallojë ndërrimin e bimësisë dhe të kafshëve nga veriu në jug dhe nga perëndimi në lindje. - Të arsyetojë hapjen e kanaleve dhe rëndësinë e tyre ekonomike në pjesën kontinentale. - Të tregojë në hartë vendburimet e njohura me minerale në regjion dhe rëndësinë e tyre ekonomike. - Të dallojë karakteristikat e këtij regjioni, si dendësinë, shtimin e lartë natyror, përkatësinë e larmishme etnike e fetare. 	<ul style="list-style-type: none"> - Për shpjegimin e Regjionit të Azisë Lindore duhet disponuar njohuri solide gjeografike, gjeologjike, gjeofizike, demografike, historike, ekonomike dhe politike.

		<p>mongole, dendësi dhe shtim i lartë natyror, niveli i lartë kulturor, zhvillim i lartë ekonomik.</p> <p>- Shtetet e Azisë Lindore: Kina, Japonia, Mongolia, Koreja Veriore, Jugore, Tajvani.</p>	<p>- Të shënojnë në hartën e punës qytetet më të njohura dhe më të mëdha si dhe monumentet materiale e kulturore të këtij regjioni.</p> <p>- ë nxjerrë konkludime të thjeshta, duke krahasuar shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, popullative, nivelit të arsimit, stukturës ekonomike etj.</p> <p>- Të përkufizohen dhe të dallohen specifikat natyrore, popullative, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të shteteve të Azisë Juglindore.</p> <p>- Kina.</p>	
Regjioni	Afrika	<p>Afrika si tërësi regjionale. Pozita, madhësia, përkufizimi.</p> <p>- Veçoritë relievoe, klimatike, hidrografike dhe biogeografike.</p> <p>- Karakteristikat demografike, kulturore dhe politike.</p>	<p>- T'i përcaktojë kufijtë e Afrikës dhe t'i tregojë përparësitë e pozitës së saj ndaj Azisë, Amerikës dhe Australisë.</p> <p>- T'i identifikojë ngushticat detare, gjiret detare, ishujt dhe gadishujt dhe t'i gjejë në hartë sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, ultësirat, fushat, luginat lumore më të njohura, shkretëtirat, gjysmëshkretëtirat, stepet, savanet dhe pyjet ekuatoriale.</p> <p>- T'i dallojë tipat e klimës përmes klimogrameve dhe t'i përshkruajë dallimet themelore të tyre.</p> <p>- T'i gjejë në hartën gjeografike lumenjtë e njohur dhe liqenet.</p> <p>- T'i dallojë nga fotografitë apo t'i caktojë në hartat gjeografike formacionet (zonat) bimore të makies mesdhetare, stepës, savaneve dhe pyjeve të pashkelura (xhunglave ekuatoriale).</p> <p>- T'i dijë se cilat kafshë të egra barngrënëse dhe mish-ngrënëse rriten dhe jetojnë në cilat regjione të Afrikës.</p> <p>- T'i shënojnë në hartën e punës të Afrikës pasuritë minerare më të rëndësishme të kontinentit.</p> <p>- Të komentojë tabelën, grafikonin e rritjes së popullsisë si dhe dendësinë e popullsisë në kontinent.</p> <p>- T'i dallojë popujt dhe grupet më të mëdha të popujve dhe racave që</p>	<p>- Shpjegimi i Afrikës si tërësi regjionale kërkon njohuri të nivelit të lartë, gjeologjik, gjeofizik, klimatik, biogeografik, demografik, historik, kulturor, ekonomik dhe politik.</p>

			<p>i takojnë kontinentit të Afrikës, regjioneve të saj dhe shteteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - T'i dallojë shtetet republikane (53) dhe monarkitë (3). - T'i vendosë në hartë-skicë qytetet më të mëdha të kontinentit. - Të tregojë pasuritë kryesore natyrore në kontinentin e Afrikës, prodhimet bujqësore e industriale me të cilat njihet Afrika. - Të tregojë cilat vende e kolonizuan Afrikën dhe si ndikuan ato në zhvillimin e saj. <p>T'i dallojë grupimet politike dhe ekonomike dhe problemet me të cilat ballafaqohet popullsia e Afrikës.</p>	
Regjioni	Afrika	<p>Afrika Veriore-Mesdhetare- - Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore.</p> <p>- Popullsia arabo-berbere e besimit islam.</p> <p>- Veçoritë e zhvillimit ekonomik.</p> <p>- Shtetet e Afrikës Veriore-Maroku dhe Egjipti.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të përkufizojë regjionin e mesdheut afrikan dhe t'i identifikojë shtetet që e përbëjnë këtë regjion. - Të dijë se ky regjion është i përcaktuar nga ndikimi i klimës dhe i detit. - Të përshkruajë relievin malor (vargmalet), rrafshlartat malore, shkretëtirat dhe masivet malore midis shkretëtirës. - Të dallojë tiparet e klimës dhe dallimet e saj nga Mesdheu e deri në tropikun e veriut. - Të tregojë shkaqet e lumenjve të shkurtër dhe me pak ujë. - Të tregojë veçoritë e ujit të detit Mesdhe dhe roli i tij në ekonomi e turizëm. - Të arsyetojë praninë e madhe të ujërave nëntokësore dhe rëndësinë e tyre. - Të paraqesë me shenja në hartën e punës vendburimet e naftës, fosfateve, hekurit, plumbit, zinkut, kripës në këtë regjion. - Të dallojë ndërrimin e bimësisë dhe të kafshëve nga bregdeti e deri në jug në tropikun e veriut. - Të identifikoj popujt që banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike. - Të gjejë lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e 	<p>Për t'i shpjeguar specifikat e Mesdheut Afrikan nevojitet njohuri gjeografike, gjeologjike, gjeomorfologjike, historike, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike.</p>

			<p>ekonomisë së këtyre vendeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të radhisë shtetet e Afrikës Mesdhetare sipas numrit të banorëve e sipërfaqes. - Të shënojë në hartën e punës qytetet më të njohura të Afrikës mesdhetare. - T'i identifikojë veçoritë natyrore, populative, kulturore e ekonomike të Marokut dhe Egjiptit. 	
Regjioni	Afrika	<p>Afrika Sudaneze -Pozita gjeografike, karakteristikat natyrore, populative, ekonomike.</p> <p>- Shtete e Afrikës sudaneze-Sudani</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të përkufizojë regjionin dhe t'i identifikojë shtetet që e përbëjnë këtë regjion. - Të tregojë veçoritë kryesore të relievit, klimës dhe hidrografisë së Afrikës Sudaneze. - Të identifikojë popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike. - Të gjejë lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve. - Të vendosë në hartën e punës shtetet e Afrikës Sudaneze dhe qytetet kryesore të tyre. - Të tregojë në specifikat relievore, klimatike, hidrografike, biogjeografike, populative, kulturore e ekonomike të Sudanit dhe ndarjen mes veriut e jugut. 	<ul style="list-style-type: none"> - T'i ndërlidhë njohuritë gjeografike, gjeomorfologjike, klimatike, biogjeografike, demografike, kulturore, sociologjike, ekonomike dhe politike.
Regjioni	Afrika	<p>Afrika Perëndimore (Guinease). - Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populative dhe ekonomike. - Shtetet e Afrikës Perëndimore (Guinease): Nigeria</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në hartë të tregohen ishujt, gjiri dhe shtetet që e përbëjnë Afrikën Perëndimore. - Të vlerësojë rolin e pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Afrikës Perëndimore. - Të shprehë rolin e Oqeanit dhe të monsunit Guineas në klimë dhe në jetën e njerëzëve. -Të përshkruajë relievin ultësiror, të pllajave dhe kodrinoro-malor. - Të ndërlidhë klimën me rritjen e pyjeve ekuatoriale dhe llojet e ndryshme të kafshëve të egra dhe të zogjve. - Të tregojë në hartë emrat, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe 	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegimi i veçorive natyrore, populative dhe ekonomike të regjionit të Afrikës Perëndimore kërkon njohuri të mjaftuara

			<p>veçoritë hidroenergjetike të lumenjve të këtij regjioni.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të tregojë në hartë vendburimet e mineraleve më të njohura dhe rëndësinë e tyre ekonomike. - Të identifikojë popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike. - Të gjejë lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve. - Të vlerësojë dhe të argumentojë strukturën bujqësore në vartësi nga kushtet klimatike. - Të shënojë në hartën e punës qytetet kryesore të Afrikës Perëndimore. 	<p>gjeografike, gjeologjike, klimatologjike, biogeografike, historike, demografike, ekonomike, politike e sociologjike.</p>
Regjioni	Afrika	<p>Afrika Qendrore Ekuatoriale.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore, popullore dhe ekonomike. <p>- Shtetet e Afrikës Qendrore Ekuatoriale: Republika Demokratike e Kongos.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi të jetë në gjendje ta bëjë përkufizimin e regjionit dhe t'i identifikojë shtetet e tij. - Të shënojë në hartën e punës bazenin e lumit Kongo, ultësirave aluviale, rrafshlartave dhe maleve të ulëta përreth. - Të shprehë varshmërinë e klimës me zonat vegjetative-pyllit ekuatorial dhe savanave në periferi dhe një botë të shumëllojshme shtazore dhe insektesh të rrezikshme për shëndetin e njeriut e të kafshëve. - Të paraqesë me shenja në hartën e punës vendburimet e naftës, gazit natyror, uranit, argjendit, arit, zinkut, hekurit etj. - Të gjejë në hartë lumenjtë më të rëndësishëm dhe t'i përshkruajë veçoritë e tyre. - T'i identifikojë popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike dhe ekonomike. - Të gjejë lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve. - Të dallojë veçoritë natyrore, popullore dhe ekonomike të Kongos. 	<ul style="list-style-type: none"> - Interpretimi i kushteve natyrore, popullore dhe ekonomike të Afrikës Qendrore kërkon njohuri të mjaftueshme gjeografike, biogeografike, gjeologjike, klimatike, demografike, ekonomike dhe politike.
Regjioni	Afrika	<p>Afrika Lindore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të tregojë se Afrika Lindore është urëlidhëse mes Lindjes së Mesme, Azisë Jugore e Lindore. 	<ul style="list-style-type: none"> - Për shpjegimin e tipareve

		<p>dhe tiparet natyrore, popullative e ekonomike.</p> <p>- Shtetet e Afrikës Lindore-Tanzania</p>	<p>- T'i gjejë në hartë malet e larta me origjinë vullkanike, rrafshlartat në veri, rrafshlartat liqenore në jug dhe rripin e gjatë të fushës bregdetare në lindje.</p> <p>- Të dallojë dhe të arsyetojë tiparet e veçanta të klimës ekuatoriale që ndryshon në mënyrë vertikale dhe horizontale.</p> <p>- Të tregojë ndërlidhjen mes tipave klimatikë dhe zonave vegjetative.</p> <p>- Të gjejë në hartë shtrirjen e pyjeve ekuatoriale, savanave dhe gjysmëshkretëtirave dhe përhapjen e kafshëve të egra në këtë regjion.</p> <p>- Të tregojë në hartë emrat, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjeve dhe veçoritë specifike të lumenjve.</p> <p>- Të identifikojë dhe të emërtojë liqenet më të njohura të Afrikës Lindore.</p> <p>- Të dallojë popujt në Afrikën Lindore sipas përkatësisë etnike e fetare dhe gjendjes sociale.</p> <p>- Të nxjerrë konkludime të thjeshta duke krahasuar shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, popullative, nivelit të arsimit, urbanizmit dhe strukturës ekonomike të tyre.</p> <p>-Të dallojë tiparet kryesore natyrore, popullative, kulturore e ekonomike të Tanzanisë.</p>	<p>natyrore, popullative dhe ekonomike të Afrikës Lindore nevojitet njohuri gjeografike, gjeologjike, biogjeografike, hidrologjike, demografike, sociologjike, ekonomike dhe politike.</p>
Regjioni	Afrika	<p>Afrika Jugore</p> <p>- Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore popullative dhe ekonomike.</p> <p>- Shtetet e Afrikës Jugore -Republika Jugoafrikane.</p>	<p>- Në hartë të tregohen se cilat brigje të Afrikës Jugore lagen me ujërat e cilit oqean dhe shtetet që përbëjnë këtë regjion.</p> <p>- Të gjenden në hartë malet, rrafshlartat, fushëgropat, shkretirat dhe fushat përgjatë brigjeve të oqeanit.</p> <p>- Të analizojë dhe të komentojë klimogramet dhe ndërlidhjet e tyre me zonat vegjetative dhe të arsyetohet rrjeti hidrografik i varfër, mungesa e liqeneve dhe të dallojë tipat e klimës mes pjesëve perëndimore, qendrore dhe lindore të regjionit.</p> <p>- Të paraqesë me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të arit, diamantit, uraniumit, kromit, hekurit, naftës, qymyrit etj.</p>	<p>- Shpjegimi i veçorive tipike të këtij regjioni kërkon njohuri të mirë gjeografike, gjeologjike, historike, sociologjike, ekonomike dhe politike.</p>

			<ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre racore, demografike, kulturore dhe ekonomike. - Të gjejë lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve. - Të bëjë lidhjen mes kushteve klimatike, veçorive të ujit të detit dhe të tregojë rolin e tyre në ekonomi e turizëm. - Nxënësi të jetë në gjendje t'i tregojë dhe t'i përkufizojë në hartë shtetet e Afrikës Jugore. - Të radhisë shtetet e Afrikës Jugore sipas lartësisë së të ardhurave për kokë banori, të shënojë në hartën e punës qytetet më të mëdha të Afrikës Jugore. -Të tregojë veçoritë kryesore natyrore, populative, sociale, ekonomike e politike të Afrikës Jugore. 	
Regjioni	Amerika	<p>Amerika si tërësi regjionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike, madhësia, përkufizimi. Karakteristikat e përgjithshme dhe veçoritë relievore, klimatike, hidrografike, biogjeografike. - Veçoritë demografike, kulturore, ekonomike dhe politike. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë pozitën gjeografike, shtrirjen, madhësinë dhe të identifikojë gadishujt, ishujt, gjiret, ngushticat dhe kanalet kryesore të Amerikës, t'i analizojë veçoritë dhe rëndësinë e tyre. - T'i dallojë zonat kryesore malore, fushore, pllajajat dhe luginat lumore më të njohura. - Të tregojë praninë e vullkaneve dhe të tërmeteve. - T'i dallojë tipat e klimës përmes klimogrameve dhe t'i ndërlidhë me tipat vegjetativë të tajgave, prerisë, makjeve, lanoseve, selvaseve, kamposeve. - T'i dijë se cilat kafshë të egra dhe rrëshqitësit jetojnë në pjesët e ndryshme të Amerikës. - T'i gjejë në hartën gjeografike lumenjtë dhe liqenet e njohura, detet dhe oqeanet, ujët e të cilave i lagin brigjet e Amerikës. - Të tregojë vendburimet më të njohura të metaleve, naftës, qymyrit, gazit e pasurive të tjera dhe rolin e tyre për zhvillimin ekonomik. - Të komentojë grafikonin e rritjes së popullsisë dhe hartën e dendësisë së popullsisë. 	<ul style="list-style-type: none"> - T'i ndërlidhë njohuritë gjeografike, gjeologjike, klimatologjike, biogjeografike, demografike, historike, ekonomike e politike.

			<ul style="list-style-type: none"> - T'i dallojë popujt dhe grupet e shumta që ndryshojnë nga raca, gjuha, kultura dhe prejardhja e tyre në Amerikë. - Nxënësi, duke u bazuar në atlas, të shënojë në hartën e punës qytetet kryesore të kontinentit të Amerikës. - Nxënësi në hartën e punës të shënoj ish-kolonitë e Spanjës, Portugalisë, Anglisë dhe Francës në kontinentin e Amerikës. Të tregojë në shkaqet që nxiten zbulimin e Amerikës dhe popullimin e saj. 	
Regjioni	Amerika	<ul style="list-style-type: none"> - Amerika Veriore. Pozita gjeografike, veçoritë natyrore. - Procesi i formimit të kombit amerikan. - Veçoritë e zhvillimit ekonomik - Shtetet e Amerikës Veriore: - SHBA dhe Kanadaja 	<ul style="list-style-type: none"> - Të vlerësojë pozitën gjeografike, përthyerjen e vijës bregdetare dhe daljen në Oqeanet e Amerikës Veriore. - Të gjenden në hartë sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, rrafshlarta e madhe, pllaja e prerive, fushat dhe luginat lumore më të njohura. - Të analizojë dhe të komentojë klimogramet dhe zonat bimore e shtazore për vendet e Amerikës Veriore dhe të arsyetohen ndryshimet e theksuara midis rajoneve, roli i rrymave oqeanike në brigjet juglindore dhe juperëndimore të regjionit. - Të shënohen në hartën e punës lumenjtë kryesorë, prania e madhe e liqeneve natyrore, ujëvareve, kanioneve dhe të arsyetohet prania e tyre në zhvillimin ekonomik të Amerikës Veriore. - Të paraqesë me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të naftës, gazit, nikelit, arit, uraniumit, plumbit, hekurit, qymyrit si dhe qendrat kryesore të industrisë. - Të arsyetojë praninë e rajoneve bujqësore dhe varësinë e tyre nga zonat klimatike dhe relievo. - Të tregojë si u formua kombi amerikan dhe kanadez. - Të dallojë popujt më të njohur që e përbëjnë popullsinë e SHBA-së dhe të Kanadasë sipas përkatësisë etnike, racore e fetare. - Të shënojë në hartën e punës qytetet më të njohura dhe më të mëdha të Amerikës Veriore. - Të nxjerrë konkludime të thjeshta, duke krahasuar shtetet sipas 	<p>Për shpjegimin e specifikave natyrore, populative, politike dhe ekonomike të Amerikës Anglosaksone nevojitet njohuri solide gjeografike, gjeofizike, historike, demografike, sociologjike, biogjeografike, ekonomike dhe politike.</p>

			madhësisë sipërfaqësore, populative, nivelit të arsimit, urbanizimit, strukturës ekonomike dhe të bëjë dallimin e organizimit politiko-administrativ mes SHBA-së dhe Kanadasë.	
Regjioni	Amerika	Amerika Latine -Amerika e Mesme - Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, populative dhe ekonomike. - Shtetet e Amerikës së Mesme - Meksika	- Të përcaktojë shtrirjen hapësinore të Amerikës së Mesme dhe t'i tregojë përparësitë e pozitës së saj ndaj Amerikës Veriore dhe Amerikës Jugore. - Nxënësi duhet të tregojë se Amerika e Mesme është urëlidhëse mes regjioneve të tjera të Amerikës. - T'i gjejë në hartë gadishujt, ishujt dhe detet që i lagin brigjet e Amerikës së Mesme. - Nxënësi duhet të dijë se Amerika e Mesme përbëhet nga tri hapësira gjeografike: pjesës kontinentale, istmike dhe ishullore. - Të dallojë dhe të arsyetojë shtrirjen e zonave klimatiko-vegjetative mes pjesëve veriore dhe jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Amerikës së Mesme. - Të gjejë në hartë Kanalin e Panamasë dhe të përshkruajë rendësinë e tij ekonomike. - Të paraqesë me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të plumbit, zinkut, bakrit, naftës, boksitit, kromit etj. - Të tregojë në hartën ekonomike zonat e prodhimeve bujqësore, si: misrit, pambukut, kallamsheqerit, duhanit, kafesë, kakaos, bananeve etj. - Të arsyetojë praninë e numrit të madh të ishujve në këtë rajon. - T'i gjejë në hartë vargmalet, vullkanet aktive, rrafshlartat, pllajat, ultësirat dhe luginat e thella ndërmallore. - Nxënësi duhet të dijë se e veçanta e klimës së këtij regjioni janë uraganet me pasoja shkatërruese. - Të dallojë popujt më të njohur në Amerikën e Mesme sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.	Për shpjegimin e kushteve dhe të dukurive natyrore të këtij regjioni kërkohen njohuri solide gjeografike, gjeologjike, historike, biogjeografike, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike.

			-Të shënojnë në hartën e punës shtetet e këtij regjioni si dhe qytetet kryesore. -Të përkufizohen dhe të dallohen specifikat natyrore dhe popullore, ekonomike dhe politike të Meksikos si shtet i rajonit.	
Regjioni	Amerika	Amerika Jugore - Pozita gjeografike, shtrirja dhe madhësia. - Veçoritë natyrore, popullore dhe zhvillimi ekonomik. - Shtetet e Amerikës Jugore: Brazili, Argjentina dhe Kili.	- Të tregojë për pozitën gjeografike, madhësinë e territorit dhe shtetet që e përbëjnë. Të dallojë tërësitë e mëdha relievo: Ultësirën e Amazonit, të Orinokos, rrafshnaltën e Guajanës, pllajën e Brazilit. - Të dallojë tipat klimatikë dhe zonat vegetative e zoogjene në të dy anët e ekuatorit. - Të ndërlidhë klimën me tipat e vegjetacionit sipas zonave. - Të tregojë në hartë emrat, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve më të mëdhenj në këtë regjion. - Të shënojnë në hartën e punës zonat e selvaseve, lanoseve, kamposeve, shtrirjen gjeografike dhe rolin e tyre në ekonomi. - Të tregojë në hartë vendburimet e mineraleve më të njohura në këtë regjion, si: hekuri, mangani, boksiti, ari, nafta, diamanti etj. - Të tregojë në hartën ekonomike zonat e prodhimeve bujqësore, si: kafeja, kakaoja, kallamsheqeri, pemët tropikale, pambuku, duhani. - Të shpjegojë dhe të arsyetojë strukturën e popullsisë së këtij regjioni sipas përkatësisë kombëtare, racore dhe fetare. - Të shënojnë në hartën e punës shtetet dhe kryeqytetet e këtij regjioni. - Të dallohen specifikat natyrore, popullore, kulturore, ekonomike e politike të Brazilit, Kilit dhe Argjentinës si vende tipike të tri regjioneve karakteristike.	Për t'i shpjeguar veçoritë natyrore popullore dhe ekonomike të këtij regjioni nevojitet ndërlidhje gjeografike, historike, demografike, kulturore e politike.
Regjioni	Australia dhe Oqeania	Australia - Pozita gjeografike, veçoritë natyrore dhe ndarja rajonale.	- Të përshkruajë dhe të analizojë pozitën gjeografike skajore në hemisferën jugore të Australisë. - Të përcaktojë relievin malor të Australisë Lindore e Perëndimore, Ultësirën Qendrore, ishujt të shpërndarë në oqean, dy gjire të mëdha: Karpentorisë në veri dhe Gjiri i Madh i Australisë në jug, Shkretëtira	Njohja e hapësirës së kontinentit të Australisë me veçoritë

		<ul style="list-style-type: none"> - Zbulimi dhe popullimi i kontinentit. - Veçoritë e zhvillimit ekonomik të Australisë. 	<p>e Madhe rënore në perëndim.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë peizazhet natyrore, si: sistemi malor i Australisë Lindore, Ultësira Qendrore dhe Australia Perëndimore. - Të dallojë tipat e klimës dhe dallimet e saja nga brigjet e oqeanit e deri në brendi. - Të ndërlidhë tipat klimatikë me zonat vegjetative. - Të arsyetojë praninë e pakët të lumenjve e të liqeneve në Australi. - Në hartën e punës t'i shënojë vendburimet e mineraleve, si: qymyrgurit, hekurit, naftës, zinkut, plumbit, bakrit, arit etj. - Të vlerësojë strukturën e prodhimitarisë bujqësore në varësi nga kushtet natyrore. - Të nxjerrë përfundime pozitive si kanë arritur njerëzit nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik. - Të shpjegojë si është bërë popullimi i Australisë në të kaluarën. - Të vendosë në hartën e punës koncentrimin regional të popullsisë (në lindje, në jug dhe në juglindje). - Të shënojë në hartën e punës qytetet kryesore të Australisë. 	<p>relievore, klimatike, biogjeografike, populative, ekonomike kërkon gërshëtimin e njohurive fiziko-gjeografike, historike dhe politike.</p>
Regjioni	Oqeania	Oqeania <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore, populative dhe ekonomike. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të dijë t'i dallojë tri grupe të mëdha ishujsh: Melanezinë, Mikronezinë dhe Polinezinë. - Të jetë në gjendje të japë vlerësim për pozitën dhe rëndësinë e ishujve në Oqeani. - Të tregojë se relievi i shumicës së ishujve është malor, por ka edhe me origjinë vullkanike dhe të koraleve. - Të ndërlidhë tipat klimatikë me zonat vegjetative. - Të identifikojë grupet kryesore që e popullojnë Oqeaninë, si: papuanët, maorët, melanezianët, mikronezianët, polinezianët, por edhe ardhacakët nga kontinentet e tjera, si: aziatikë, amerikanë, evropianë etj. - Të përshkruajë karakteristikat e përbashkëta, si: ngjyrën e errët të 	<p>Shpjegimi i kushteve natyrore, demografike, ekonomike dhe politike të Oqeanisë kërkon njohuri gjeografike, gjeofizike, demografike, ekonomike dhe</p>

			lëkurës, flokët e zezë, kaqurrela etj. - Të paraqesë në hartën e punës vendburimet e mineraleve, si: ari, argjend, bakër, nikel.	politiko-historike.
Regjioni	Krahinat polare	Krahinat polare Karakteristikat e përgjithshme natyrore.	<ul style="list-style-type: none"> - T'i përkufizojë viset polare në globin gjeografik. - Të shpjegojë dallimet dhe ngjashmëritë mes Arktikut dhe Antarktikut. -Të dijë se për shkak vështirësive të shumta natyrore Antarktiku është kontinenti i fundit i shkelur nga njeriu. - T'i identifikojë ishujt e Arktikut evropianë, aziatikë dhe amerikan. - Nxënësi duhet të dijë se Arktiku zihet në pjesën më të madhe nga Oqeani i Ngrirë i Veriut. - Të ndërlidhë klimën e Arktikut me bimësinë e varfër dhe shtazët e egra të pakëta. - Të identifikojë popujt që i banojnë ishujt e Arktikut dhe veçoritë e tyre demografike dhe ekonomike. - Nxënësi duhet të dijë se kontinenti i Antarktidës është më i largët dhe më i izoluar në të gjithë rruzullin tokësor. - Të tregojë se relievi i Antarktidës është malor-vazhdim i Andeve të Amerikës së Jugut. Të shënojë në hartën e punës vendburimet e mineraleve në Antarktidë. - Nxënësi duhet të dijë se Antarktida është kontinent i mbuluar me shtresa të trasha akulli. - Nxënësi të vlerësojë mungesën e lumenjve në këtë kontinent. - Të shprehë varësinë e klimës, florës dhe faunës në Antarktidë. - Të nxjerrë konkludime për mungesën e vendbanimeve të përhershme në Antarktidë. 	Shpjegimi i krahinave polare kërkon njohuri solide fiziko-gjeografike, gjeologjike, biogjeografike, demografike, ekonomike dhe politike.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Lënda e gjeografisë mund të mësohet dhe të interpretohet përmes metodave dhe teknikave të ndryshme. Zbatimi i metodave dhe i teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit mësimor është e drejtë dhe obligim profesional i arsimtarëve. Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, si në aspektin teorik, ashtu edhe aplikativ, të tregohet kujdes i veçantë. Metodologjia duhet të zgjedhet paraprakisht në përputhje me përmbajtjen e temës, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia duhet të jetë në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit të shpejtë e të saktë të njohurive, shprehive dhe vlerave. Në grupin e metodave verbale rekomandohet të përdoren metodat e shpjegimit, bashkëbisedimit, demonstrimit, diskutimit të lirë etj. Këtu bëjnë pjesë edhe diskutimet me nxënësit, në dyshe, në grupe, ndërsa të nxënit në bashkëpunim mund të bëhet përmes teknikave të ndryshme.

Baza materiale e mësimin të gjeografisë

Mësimi bashkëkohor i gjeografisë mund të realizohet në tërësi, duke përdorur:

- **objektet mësimore** (klasën, kabinetin dhe natyrën);
- **mjetet mësimore** (vizuele dhe audiovizuele);
- **mjetet teknike ndihmëse** (dërrasën e zezë, aparatet projektuese, TV, radio, arkën e rërës, modelet, CD-të) etj;
- **bibliotekën e shkollës**;
- **mjetet e punës së nxënësve** (librin mësimor, libër leximi të gjeografisë, fletoren e punës, materialet ilustrative, treguesit hartografikë, fotografitë, diagramet, grafikonet, tabelat, fjalorin gjeografik, atlasin gjeografik, hartat konture dhe memece, prerjet, bllok-diagramet, skemat, instrumentet matëse etj.).

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë kanë rëndësi të madhe, ngase lënda e gjeografisë ka karakter vizuel. Paraqitja indirekte e

së vërtetës gjeografike përcillet me **fjalën e gjallë** dhe me përdorimin e **mjeteve mësimore**. **Demonstrimi** është detyrë e arsimtarit, kurse **vëzhgimi** është obligim i nxënësit.

Vëzhgimi mund të jetë i drejtpërdrejtë dhe **indirekt** me përdorimin e:

- ❖ **fotografive, filmit, emisioneve televizive**, kompjuterit, modeleve, maketave, globit, hartave me shkallë të madhe (plane), të mesme, të vogël, gjeografike, fizike, shoqërore, ekonomike, memece, imazheve satelitore etj.;
- ❖ **vizatimeve gjeografike** (vizatime lëndore, diagrame, grafikone, hartograme);
- ❖ **vlerave numerike** (përmes tabelave etj.);
- ❖ **librave mësimorë, librave të leximit, revistave gjeografike** etj.

Format e punës në mësimin e gjeografisë

Në procesin mësimor do të përdoren disa forma të punës, me qëllim të aktivizimit të nxënësve për ta bërë mësimin sa më të efektshëm:

- forma **individuale** e punës;
- forma e punës në **çifte**;
- forma e punës në **grupe**;
- forma me **gjithë klasën**;
- **format e veçanta** të mësimin të gjeografisë, si mësimi i programuar, mësimi i shtuar apo suplementar, mësimi plotësues, mësimi vazhdues, aktivitetet e lira, mësimi ekipor etj;
- **vështrimet në rrethinë, ekskursionet** mësimore gjeografike.

Metodat dhe teknikat e punës në mësimin e gjeografisë

Prej metodave do të aplikohen:

- **metodat verbale** - metoda parafolëse (frontale), bashkëbiseduese, dialogu dhe diskutimi;
- **metoda tekstuale**;

- **metoda demonstrative ilustrative** (demonstrimi i ilustrimeve, modeleve, simulimeve, lëndëve, objekteve);
 - a) demonstrimi në mjedisin jetësor;
 - b) demonstrimi në klasë apo në kabinetin gjeografik;
 - c) vëzhgimi i drejtpërdrejtë gjeografik;
 - ç) vështrimi i objekteve, i dukurive e i proceseve gjeografike në hapësirë;

Përveç metodave mësimore të lartpërmendura, gjatë procesit mësimor duhet të përdoren edhe **teknika të tjera të mësimdhënies**, si:

- ❖ **brainstormingi (stuhi mendimesh);**
- ❖ **diskutimi që zgjedh problemin;**
- ❖ **mësimi zbulues;**
- ❖ **teknika e hartimit dhe e drejtimit të pyetjeve;**
- ❖ **pema e mendjes (harta e mendimit, teknika klaster);**
- ❖ **gjuha grafike e komunikimit;**
- ❖ **inserti;**
- ❖ **tabela e insertit;**
- ❖ **tabela (harta) e koncepteve;**
- ❖ **grupet e ekspertëve (xhikso me ndërthurje);**
- ❖ **rrjeti i diskutimit;**
- ❖ **di-dua të diç – mësoj;**
- ❖ **ditari dypjesësh;**
- ❖ **termat paraprakë;**
- ❖ **eseu (studimi i vogël);**
- ❖ **diagrami i Venit;**
- ❖ **programi televiziv;**
- ❖ **kubimi;**
- ❖ **DRTA;**
- ❖ **Turi i galerisë;**
- ❖ **Pesëvargëshi;**
- ❖ **Fjalën e fundit ruaje për mua, etj.**

Verifikimi i diturive të nxënësve

Verifikimi dhe vlerësimi i **shkallës së përvetësimit** të dijes gjeografike nga nxënësit është proces tepër i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të këtij programi. Më të frytshme konsiderohen: verifikimi, notimi dhe vlerësimet sistematike. Duhet të verifikohen dhe të vlerësohen **sasia dhe cilësia e diturive të nxënësve, si faktet dhe objektet gjeografike**, konceptet dhe shkathësitë.

Funksionet e verifikimit dhe të vlerësimit janë:

Dituritë e nxënësve **duhet verifikuar në mënyrë sistematike**. Në fazën e verifikimit **kontrollimi** mund të bëhet **frontalisht**, duke i nxitur nxënësit me pyetje të shkurtra, të shpejta, që kërkojnë dije faktike, gjeturi topografike, njohje të disa shënimeve.

Format e verifikimit

Gjatë vitit shkollor duhet zbatuar disa forma të kontrollit:

- **verifikimi me gojë** mund të jetë **individual dhe grupor** në çdo orë mësimore;
- **verifikimi me shkrim**, po ashtu, mund të jetë **frontal dhe individual**. Kjo formë e verifikimit disa nxënësve u përgjigjet më shumë. Detyrën, problemin e dhënë nxënësit duhet ta zgjedhin brenda kohës së caktuar;
- **verifikimi përmes detyrave tekstuale-grafike**. Në praktikën mësimore detyrat e këtilla paraqiten në listat kontrolluese dhe në testet e diturive;
- **verifikimi përmes zgjedhjes së punëve praktike** arrihet përmes verifikimit të diturive, fakteve, mënyrën e të menduarit gjeografik, shkallën e përvetësimit të shkathësive e shprehive;
- **verifikimi i detyrave shtëpiake**. Për notim veçanërisht janë të përshtatshme punimet e pavarura, referatet, zgjidhja e ndonjë problemi praktik në mënyrë të pavarur.

VLERËSIMI DHE NOTIMI

Çdo shprehje e nxënësit me gojë, me shkrim apo praktik, e që ka të bëjë me mësimin e gjeografisë, do të duhej vlerësuar. Vlerësimi përfshin notimin për punën dhe dijen e shfaqur. Pas vlerësimit pason notimi.

Vlerësimi kërkon: objektiva të qartë mësimorë, motivim të nxënësve, njohjen e përvojës dhe të aftësive të nxënësve.

Vlerësimi bazohet: ç'thon nxënësit, ç'shkruajnë nxënësit, ç'bëjnë nxënësit.

Etapat e vlerësimit: kontrolli, p.sh. ç'dinë (ç'është arritur) dhe çfarë nuk dinë nxënësit (çka nuk është arritur), **matja dhe vlerësimi.**

Notimi duhet të jetë **publik dhe me nota të plota.** Puna mësimore duhet të vlerësohet në mënyrë sistematike. Thelbi i vlerësimit është zbatimi efikas i evidencës, i verifikimit dhe i notimit.

Tipat e vlerësimit

- **Vlerësimi formues;**
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim notimi pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies, p.sh., pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti etj.;
- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathësitë e zotëruara paraprake;
- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësitë dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta;
- **Vlerësimi i brendshëm** formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi;
- **Vlerësimi i jashtëm** hartohet jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë në Ministri, zyrtarët rajonalë dhe komunalë);
- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në bazë të kontrollit të punës së nxënësve në klasë;
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues;
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të lëndës së gjeografisë;
- **Vlerësimi si proces** bazohet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune apo detyre në zhvillim;
- **Vlerësimi orientues** është i nevojshëm për orientim në profesion dhe zhvillimin vetjak;

- **Vetëvlerësimi** është proces gjatë të cilit mësuesi, shkolla, nxënësi mbledhin informata për veten dhe bëjnë gjykimin e vlerave të tyre.

Instrumentet e vlerësimit janë:

Mësimdhënësi i lëndës duhet të zgjedhë dhe të zbatojë një numër instrumentesh për matjen dhe vlerësimin, siç janë:

- **vrojtimi,**
- **pyetësi (vetëvlerësimi),**
- **raporti me shkrim i një pune praktike apo hulumtimi,**
- **të shprehurit me gojë,**
- **të shprehurit me shkrim,**
- **fleta kontrolluese** (përdoret për shkathësitë manovruese të nxënësit),
- **dosja ose portofoli (vetëvlerësimi),**
- **testi.**

Testi duhet të jetë i bazuar në kritere dhe objektiva.

Testi i arritshmërisë duhet të ndërtohet nga kërkesat ose pyetjet:

- me përgjigje alternative të shumta,
- me përgjigje të hapura të shkurtra,
- me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.
- dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Teksti shkollor dhe fletoret e punës për klasën përkatëse
2. Atlasi gjeografik shkollor
3. Metodologjia e mësimdhënies
4. Hartat e ndryshme të Evropës
5. Globi, instrumente meteorologjike, hidrometrike etj.
6. Revista profesionale dhe shkollore
7. Fotografii, postere, gazeta
8. Programe kompjuterike, internet, CD, fotoslajde, filma, videokaseta etj.

HYRJE

Programi i Edukatës qytetare është hartuar duke pasur parasysh moshën e nxënësve, njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga mësimi i kësaj lënde në klasat e mëparshme, por edhe nga lëndët e tjera që ofrojnë përmbajtje të përafërta me këtë lëndë mësimore.

Njohuritë e fituara nga kjo lëndë nëpër klasat e mëparshme i shërbejnë nxënësit si bazë për krijimin e njohurive dhe shkathtësive të reja nga fusha e qytetarisë – kryesisht të atyre që lidhen me të drejtat e njeriut, detyrat dhe me përgjegjësitë e qytetarit si dhe me jetën ekonomike – si një prej aspekteve më të rëndësishme të jetës shoqërore. Liritë dhe të drejtat njerëzore janë shtruar edhe në klasat e mëparshme (sidomos në klasën VI), por në klasën VIII fusha e të drejtave, detyrave dhe përgjegjësive do të ndërlihet më tepër me fushën e ekonomisë. Kjo ndërlihdje e njohurive dhe shkathtësive qytetare me fushat shumë konkrete si ekonomia, prodhimi, konsumi, shkenca dhe teknologjia, u ndihmon nxënësve të parapërgatiten si akterë të ardhshëm e të rëndësishëm në planin e sferës më vitale të shoqërisë – ekonominë.

Nxënësit e klasës VIII janë në moshën kur rrumbullakësojnë një cikël të rëndësishëm të shkollimit dhe duhet të rifillojnë ciklin tjetër po ashtu shumë të rëndësishëm - atë të orientimit dhe pastaj përcaktimit profesional. Njohuritë e fituara më parë për klubet, shoqatat dhe institucionet, do t'u shërbejnë nxënësve si përvojë e rëndësishme për të cilën do të bëhet përshtatja më e lehtë e logjikës së aktivitetit vullnetar me logjikën e punës dhe aktivitetit profitabil. Këtë do ta mundësojnë edhe njohuritë dhe shkathtësitë e fituara mbi rolin e shkencës dhe të teknologjisë në jetën e njeriut dhe në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë.

QËLLIMET E LËNDËS

Lënda e Edukatës qytetare ka për qëllim:

- të mundësojë njohjen e të drejtave, të detyrave dhe të përgjegjësisive të qytetarit si dhe të organizatave e të dokumenteve më të rëndësishme për të drejtat e njeriut/fëmijëve;
- të bëjë vetëdijësimin për rëndësinë e respektimit të të drejtave dhe të përgjegjësisive njerëzore dhe të ndihmojë në zhvillimin e aftësive për kundërshtimin e diskriminimit mbi bazën e moshës, gjinisë, prejardhjes etnike, statusit ekonomik etj.;
- përgatitja për pjesëmarrje aktive në jetën sociale, ekonomike dhe politike në shoqërinë demokratike kosovare;
- të zhvillojë njohuritë bazë për punën dhe ekonominë si fushat më të rëndësishme shoqërore si dhe për mënyrat e organizimit dhe funksionimit të ndërmarrjeve ekonomike;
- të krijojë te nxënësit shprehitë e kursimit dhe të konsumit të planifikuar;
- t'i ndihmojë nxënësit të kuptojë lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet ekonomisë dhe mjedisit si dhe t'i njohë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;
- t'i ndihmojë nxënësit të kuptojë rëndësinë e shfrytëzimit të planifikuar të pasurisë vendore, mënyrën dhe rëndësinë e menaxhimit të drejtë të resurseve ekonomike të Kosovës;
- t'i zhvillojë njohuritë e nxënësit për rolin e shkencës dhe të teknologjisë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, por edhe për përparimin e përgjithshëm social dhe personal.

OBJEKTIVAT E LËNDËS

Nxënësi i kësaj klase duhet të arrijë këta objektiva:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- në fushën e tolerancës ndaj personave me përkatësi tjetër gjinore, etnike, fetare, kulturore, racore;
- duke i kundërshtuar format e ndryshme të diskriminimit mbi bazën e moshës, gjinisë, përkatësisë fetare, kombëtare, racore;

- Duke u bërë kureshtar dhe i vullnetshëm për njohuritë rreth aktiviteteve të organizatave që për funksion bazë kanë shërbimet ekonomike dhe komerciale.

Të njohë

- ligjin e punës, të drejtën për punë si njëra ndër të drejtat elementare si dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e punëtorëve në punë;
- konceptet si: ndërmarrje, kompani, korporatë, menaxhim dhe konceptet e tjera që lidhen me fushën e ekonomisë dhe të tregut;
- format e ndryshme të ndërmarrjeve (ndërmarrje publike, private, e përzier).
- gjendjen dhe resurset kryesore të ekonomisë kosovare;
- mënyrat e ndikimit dhe pjesëmarrjes së punëtorëve në drejtimin e ndërmarrjeve;
- trendet e zhvillimit të teknologjisë e sidomos të asaj informative.

Të kuptojë

- detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarit në përgjithësi, por edhe detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorit, udhëheqësit dhe drejtorit në ndërmarrje;
- rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në qeverisjen e ndërmarrjeve dhe mënyrat e ndikimit në qeverisje;
- parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rëndësinë e zbatimit të tyre duke filluar prej nivelit lokal deri në atë global;
- rëndësinë e organizimit sindikal për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në punë;
- format e ndryshme të diskriminimit dhe shfrytëzimit të punës së fëmijve;
- rolin e shkencës dhe të teknologjisë në zhvillimin e shoqërisë.

Të vlerësojë

- përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive që i përkasin si qytetar;
- rëndësinë e udhëheqjes së drejtë për zhvillimin e ndërmarrjes, biznesit ose institucionit, por edhe të shoqërisë në përgjithësi;
- ndikimin e shkencës dhe të teknologjisë në jetën e përditshme.

Të zbatojë

- detyrat dhe përgjegjësitë personale që kanë të bëjnë me jetën në: familje, shkollë, komunitet dhe në shoqëri;
- njohuritë e fituara nga shkenca dhe teknologjia me rastin e komunikimit, informimit;
- shprehitë e kursimit dhe konsumit të planifikuar.

Të analizojë

- efektet e veprimeve që kanë të bëjnë me konsumin dhe kursimin e të mirave materiale;
- efektet dhe rezultatet e shkencës dhe teknikës për zhvillimin e prodhimit dhe shërbimeve në fushën e ekonomisë.

Të sintetizojë

- rolin e shkencës dhe të teknologjisë në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë dhe të shoqërisë.

STRUKTURA E LËNDËS

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	NUMRI I ORËVE
TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË	Liritë dhe të drejtat e njeriut /fëmijëve	6
	Detyrat dhe përgjegjësitë	5
EKONOMIA DHE TEKNOLOGJIA	Puna, prodhimi dhe konsumi	10
	Tregu dhe shpërndarja	8
	Shkenca, teknologjia dhe shoqëria	8

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

Liritë dhe të drejtat e njeriut / fëmijëve

Nxënësi të mësojë se: çka janë dhe cilat janë të drejtat qytetare, kulturore, ekonomike, politike, dhe sociale; mbrojtjen ligjore të të drejtave të njeriut; cilat janë organizmat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe në botë; format e ndryshme të diskriminimit, por edhe të luftimit të diskriminimit njerëzor (diskriminimi në punë); dhe rëndësinë e dokumenteve për të drejtat e njeriut si dhe ndikimi i tyre për paqen në botë.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- dallon llojet e ndryshme të organizatave dhe të shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve;
- analizon punën e shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë;
- analizon nevojat për aktivitete të reja në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve në Kosovë;
- kupton format e ndryshme të diskriminimit në punë;
- vlerëson lidhjet e bashkëpunimit ndërmjet organizatave që merren me fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut/fëmijëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Nxënësi të mësojë: cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarit në shoqërinë demokratike; respektimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, pagesën e taksave, pjesëmarrjen në qeverisje; çka është ndjenja e përgjegjësisë?.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarit në shoqërinë demokratike;

- dallon detyrat prej përgjegjësive;
- analizon llojet e detyrave dhe përgjegjësive të qytetarit;
- vlerëson ndjenjën e përgjegjësisë për veprimet që i ndërmerr në komunitet.

Puna, prodhimi dhe konsumi

Nxënësi të mësojë:

Për punën si aktivitet dhe kusht i domosdoshëm i ekzistencës së njerëzve dhe i mirëqenies sociale; ligjin e punës; të drejtat e punëtorëve dhe mbrojtjen në punë.

Çka është ekonomia? Ekonomia tradicionale, ekonomia e planifikuar dhe ekonomia e tregut; degët e ekonomisë; ekonomia e Kosovës.

Për llojllojshmërinë e resurseve ekonomike dhe pasurive natyrore të Kosovës.

Për pasojat nga shfrytëzimi i padrejtë dhe i paplanifikuar i resurseve natyrore.

Klasifikimet e ndryshme të ndërmarrjeve ekonomike: (publike – private; të vogla – të mesme – të mëdha; prodhuese- tregtare –shërbyese).

Procesi dhe faktorët e prodhimit. Sistemi i qarkullimit të kapitalit dhe investimet. Sistemi i pagesave, bankat, tatimet.

Shkollimi, profesionet, si dhe nevojat e përhershme për aftësim profesional.

Problemet sociale si papunësia, varfëria në Kosovë dhe në botë.

Për nevojat e kursimit dhe konsumit të planifikuar.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- kupton se puna është kusht i rëndësishëm për begatimin e jetës personale, familjare dhe kolektive;
- dallon ekonominë tradicionale, ekonominë e planifikuar dhe ekonominë e tregut;
- analizon format e ndryshme të diskriminimit në punë ose të shkeljes së të drejtave të punëtorëve;
- vlerëson rolin e ndarjes së punës dhe të profesioneve për zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë;
- shpjegon rëndësinë e kursimit dhe dëmet nga konsumi i tepruar.

Tregu dhe shpërndarja

Nxënësi të mësojë çka është: tregu dhe ekonomia e tregut; konkurrenca dhe monopoli; oferta dhe kërkesa; tregu lokal, regjional dhe ai botëror; transporti dhe llojet e transportimit; çmimi dhe cilësia e mallit; reklama dhe marketingu.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- Kupton se tregu është forma më e përhapur e këmbimit të të mirave materiale;
- Shpjegon çka është oferta dhe çka është kërkesa;
- Kupton se si caktohet çmimi i një malli;
- Shpjegon rëndësinë e reklamës dhe marketingut për zhvillimin e aktiviteteve në biznes.

Shkenca, teknologjia dhe shoqëria

Nxënësi të mësojë për: rolin e shkencës dhe të teknologjisë në zhvillimin e ekonomisë, industrisë, kulturës dhe jetës së përditshme; revolucionin informatik dhe ndikimin i internetit; për zbatimin e teknologjive të reja në të gjitha fushat e jetës njerëzore; ndikimet e shkencës dhe të teknologjisë në mjedisin jetësor; lidhjen ndërmjet etikës, në njërën anë, dhe shkencës e teknikës, në anën tjetër.

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- shpjegon rolin e shkencës dhe të teknologjisë si faktorë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë;
- vlerëson rëndësinë e zbatimit të teknologjive të reja në prodhim dhe dëmet nga teknologjitë e tejkualuar.
- vlerëson funksionin e shkencës në krijimin e një rrjeti shumë të gjerë të komunikimit ndërmjet njerëzve.

QASJA NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Për dallim prej klasave të mëparshme përmbajtja programore e Edukatës qytetare për klasën VIII pak a shumë dominohet prej temave që i përkasin fushës së ekonomisë dhe teknologjisë. Fakti se në këtë plan dhe program janë futur probleme nga fusha e ekonomisë, flet se Edukata qytetare ka lidhje me **ekonominë**. Disa koncepte elementare nga fusha e ekonomisë si: kapitali, investimi, paraja, tregu, prodhimi, konsumi etj., do të jenë pjesë mësimore të planit dhe programit të kësaj lënde.

Lidhjen me **historinë** e mundësojnë përmbajtjet programore të katër nënkategorive kryesore lëndore: (1. Liritë dhe të drejtat e njeriut, 2. Puna, prodhimi dhe konsumi dhe 3. Tregu dhe shpërndarja, dhe 4. Shkenca dhe teknologjia). Përmbajtjet mësimore të këtyre temave do të lidhen edhe me aspektet historike të zhvillimit të tyre që do të mësohen edhe në lëndën e historisë. Pra, me **historinë**, edukata qytetare ka lidhje të ngushtë po aq sa edhe me **gjeografinë**, sepse trajtohen probleme shoqërore ekonomike që kanë të bëjnë me vende të ndryshme dhe në kohë të ndryshme.

Edukata qytetare lidhet me **gjuhën shqipe** për faktin se kultura gjuhësore e nxënësit pasurohet edhe me terma dhe shprehje nga fusha e ekonomisë gjë që ndihmon në zhvillimin e kulturës qytetare të nxënësit.

Me **artin figurativ**, ka lidhje sepse përmes figurave (grafikëve, tabelave) ose vizatimeve të tjera paraqiten në formë vizuale problemet e ndryshme ekonomike, shoqërore dhe qytetare.

Me **matematikën** po ashtu krijon lidhjen, duke përdorur grafikë, shifra dhe llogaritje të ndryshme statistikore.

Me **fizikën** dhe **teknologjinë** lidhet përmes përmbajtjeve që dalin nga nënkategoria: shkenca dhe teknologjia, si dhe me nevojën e përdorimit të mjeteve teknike: kompjuterëve, kasetofonave, kamerave, diktafonave, fotoaparateve, etj. në mësimin e kësaj lënde.

METODOLOGJIA

Për të realizuar planin dhe programin e Edukatës qytetare do të duhej që mësimdhënësit të përdorin një varg metodash – në vartësi nga përmbajtjet, por edhe nga detyrat që duhet t'i realizojnë nxënësit në kuadër të kësaj lënde. Shpjegimet dhe diskutimet në klasë, leximi i literaturës, puna në grupe, puna individuale, aktivitetet praktike, shfrytëzimi i internetit, aktiviteteve skenike, shfrytëzimi i multimedive, vizitat në terren, mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe paraqitja e tyre,

përbëjnë metodat që do të përdoren në mësimdhënien dhe në mësimnxënien e Edukatës qytetare.

Metodologjia e mësimdhënies është proces i gjatë, i cili nuk fillon dhe përfundon në klasë, por përfshin tri etapa:

1. Planifikimin dhe përgatitjen,
2. Zhvillimin e mësimin, drejtimin e mësimin, klimën në klasë, disiplinën dhe vlerësimin e përparimit të nxënësve. E.R.R. (shih literaturën nr. rendor 11),
3. Vetëvlerësimin dhe reflektimin pas mësimin.

Mësimdhënia, mësimnxënia dhe ndërlidhja e pozicioneve arsimtar-nxënës përqendrohet nëpër tri faza.

1. Para mësimin
2. Gjatë mësimin
3. Pas mësimin

Në etapën e parë hyjnë: motivimi, objektivat, vlerësimi, burimet dhe mbikëqyrja e kohës etj.

Në etapën e dytë struktura e orës E.R.R.

Në etapën e tretë hyjnë: zgjerimi përtej temës (veprimtari të zgjeruara)

Ajo që e karakterizon mësimdhënien e suksesshme është menaxhimi i orës mësimore nga ana e arsimtarit, duke përdorur dhe përzgjedhur teknika dhe metoda të përshtatshme gjatë orës. Po i përmendim disa sosh.

Në evokim: organizuesit e përparuar, organizuesi grafikë, breinstorming, leximi i drejtuar, shkrimi i lirë etj.

Në realizim të kuptimit: I.n.s.e.r.t. ditari dy pjesësh, mësimdhënia e ndërsjellë, leksioni i avancuar etj.

Në reflektim: klaster, rrjeti i diskutimit, ese 5min. A.T.S. etj.

Është shumë e rëndësishme që mësimdhënësi të jetë i aftë në planifikim dhe në përgatitjen e orës mësimore, organizimin e të nxënësve, drejtimin e klasës, motivimin e nxënësve, komunikimin me ta si dhe gjykimin dhe vlerësimin e tyre.

VLERËSIMI

Përparimi i nxënësve në Edukatën qytetare nuk mund të matet vetëm me momentin e pyetjes, por në gjithë procesin e angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive në klasë, në shkollë, në komunitet. Me rastin e vlerësimit të nxënësve në Edukatën qytetare nuk duhet mbështetur vetëm në informatat njohëse, por edhe në shkathtësitë e treguara në aktivitetet e ndryshme praktike si sjelljet me rrethin, vrojtimet në komunitet, mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të rëndësishme për shpjegimin e temave të parapara me planin dhe programin e kësaj lënde.

Pse bëhet vlerësimi?

- për të siguruar informacion rreth përparimit të nxënësve,
- për t'i motivuar nxënësit,
- për t'i realizur objektivat e planifikuar,
- për të vlerësuar gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Vlerësimi duhet të jetë sistematik dhe i llojllojshëm. Këto janë llojet e vlerësimit, të cilat mund dhe duhet të zbatohen në lëndën Edukatë qytetare: vlerësimi formues, përmbledhës, diagnostikues, i brendshëm, i jashtëm, i përditshëm, paraprak, i vazhdueshëm, objektiv etj.

Realizimi i vlerësimit, siç po shihet bëhet në forma dhe në lloje të ndryshme: me gojë, me shkrim, praktikë, tema përbledhëse, dosje, teste, detyra dhe provime. Këto lloje vlerësimesh bëhen me qëllim që nxënësit të krijojnë shprehi pune, aftësi shkrimi, leximi, aftësi studiuëse, organizuese, aftësi personale dhe shoqërore si, motivimi për të punuar në grup. Ky lloj diversiteti vlerësues ndihmon në kompleksin e formimit të personalitetit të nxënësit.

Përparimi i nxënësve në Edukatën qytetare nuk mund të matet vetëm me momentin e pyetjes, por në gjithë procesin e angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive në klasë, në shkollë, në komunitet. Me rastin e vlerësimit të nxënësve në Edukatën qytetare nuk duhet mbështetur vetëm në informatat njohëse, por edhe në shkathtësitë e treguara në aktivitetet e ndryshme praktike si sjelljet me rrethin, vrojtimet në komunitet, mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të rëndësishme për shpjegimin e temave të parapara me plan dhe program të kësaj lënde.

Vlerësimi nuk duhet të jetë vetëm proces i njëanshëm (arsimtar – nxënës), por ai duhet të jetë proces i shumanshëm. Te nxënësit duhet të

kultivohen shprehitë e vlerësimit kritik për përmbajtjet dhe për metodologjinë e mësimdhënies e të vlerësimit.

Për të mirën e shkollës, komunitetit e sidomos të vetë nxënësve do të duhej që shkolla të krijojë kushte që nxënësit, jo vetëm të vlerësohen, por edhe vetë të vlerësojnë.

LITERATURA

1. David C. Saffell, *CIVICS Responsibilities and Citizenship*, Grade 9, Westerville, Ohio, 2000
2. James E. Davis & Phyllis Maxey Fernlund, *CIVICS Participating in Government*, New Jersey 2001
3. Center for Civic Education, *We the People...*, Level II, 1993
4. Richard T. Schaefer & Robert P. Lamm, *Sociology*, The McGraw-Hill Companies, Inc. 1998
5. Zejnullah Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut I, II*, Universiteti i Prishtinës, 2001
6. Erlehta Mato, Bajram Shatri, Edukata qytetare 6 – **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2004
7. Erlehta Mato, Bajram Shatri, Edukata qytetare 7 – **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2004
8. Erlehta Mato, Bajram Shatri, Edukata qytetare 10 – **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2004
9. Demë Hoti, Naser Zabeli, Edukata qytetare 11 - **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2004
10. Shemsi Krasniqi, *Edukata qytetare*, klasa VI, Dukagjini, Pejë, 2004
11. Muhamet Mazreku, *Edukata qytetare*, Klasa IX, Libri shkollor, Prishtinë, 2003
12. Xhemali Beluli, *Kultura qytetare*, klasa VII, Shkup, 2002
13. Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qiriçi, *Hyrje në ekonomi*, Pegi, Tiranë, 2002
14. Halim Haziraj, *Ekonomia e mirëqenies dhe problemet sociale*, Suharekë, 2003

15. *Planifikimi i mësimi dhe vlerësimi*, KEC & ARA, Tiranë, 2001
16. Bardhyl Musai, *Metodologjia e mësimdhënies*, Tiranë, 2003
17. Bardhyl Musai, *Psikologji e edukimit*, Tiranë, 1999
18. Osman Buleshkaj & Robert C. Nizzi, *Mesazhe nga klasa*, KEDP, 2003
19. www.dadalos.org
20. www.unicef.org
21. www.ilo.org

EDUKATË MUZIKORE

HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut.

Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij, duke ia formuar mjedisin tingëllor. Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, del dhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor.

Edukata muzikore mundëson:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale - instrumentale dhe në veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtejshëm, i cili nxit interesim më të gjerë për muzikën, përkatësisht përgatitjen për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse.

QËLLIMET

- Të sjellë gëzim, emocione dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;
- Të zhvillojë dhe të ngritë muzikalitetin në vazhdimësi;
- të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;
- të edukojë për përzgjedhje selektive të programeve muzikore dhe për mjedis të shëndoshë tingëllor;
- të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik;

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit do të:

- ***njohin vepra të përzgjedhura muzikore nga kompozitorët botërorë dhe kombëtarë të epokave dhe të stileve të ndryshme:***
 - vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës, mjetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjuara;
 - dallojnë llojet (gjinitë) dhe zhanret e ndryshme muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
 - dallojnë format e caktuara muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
- ***muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale:***
 - interpretojnë këngë (popullore, artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë) me dhe pa shoqërim instrumental;
 - interpretojnë në instrumente të ndryshme, shoqërimet të këngëve dhe përmbajtje të veçanta instrumentale;
 - zhvillojnë aftësitë për këndim të drejtë dhe të bukur në nivel më të lartë (qëndrimi i trupit, frymëmarrja, artikulimi, këndimi shprehjeplotë, gradacionet në temp dhe në dinamikë);
 - zhvillojnë në nivel më të lartë ndjenjën ritmike, melodike e harmonike përmes interpretimit dhe dëgjimit;
 - zbatojnë dukuri të ndryshme ritmike, melodike dhe shkrimin notal;
- ***zhvillojnë kreativitetin:***
 - riinterpretojnë në mënyrë krijuese veprat e interpretuara;
 - plotësojnë, ndryshojnë dhe krijojnë tërësi melodike dhe ritmike;
 - shprehen në mënyrë kreative me lëvizje, shprehje figurative e letrare në bazë të përjetimit të veprës së dëgjuar muzikore;
- ***zhvillojnë të menduarit kritik:***
 - vlerësojnë interpretimin individual dhe të përbashkët;
 - vlerësojnë ngjarjet muzikore në mjedisin e tyre.

	VEPRIMTARITË MUZIKORE	PËRMBAJTJET TEMATIKO-INFORMATIVE	REZULTATET E PRITSHME	BURIMET ARTISTIKE MUZIKORE-SHEMBUJT E PROPOZUAR PËR DËGJIM
D Ë GJ I M	<ul style="list-style-type: none"> • dëgjojnë në mënyrë përjetuese dhe analitike vepra muzikore; • njohin dhe dallojnë muzikën instrumentale, vokalo-instrumentale dhe skenike; • dallojnë muzikën programore dhe absolute; • njohin shprehjen homofonike dhe polifonike; • dallojnë cilësitë e këngës popullore; • njohin cilësitë e muzikës së lehtë; 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ vepra e kompozitorë të epokave, stileve, llojeve dhe zhanreve të ndryshme; ➤ kantata, oratorio opera, opereta, baleti, vallja koreografike mjuzikëlli, muzika në film dhe në dramë ➤ poema simfonike ➤ vepra përkatëse homofonike dhe polifonike ➤ kënga popullore autoktone dhe ajo e kompozuar në këtë frymë ➤ xhaz, rok, pop, rep 	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ rinjohin veprat e dëgjuara të kompozitorëve nga epokat dhe stilet e ndryshme; ➤ rinjohin dhe dallojnë format e veprave të caktuara muzikore; ➤ rinjohin dhe dallojnë veprat e dëgjuara programore dhe absolute; ➤ rinjohin dhe dallojnë shprehjen homofonike dhe polifonike; ➤ rinjohin dhe dallojnë cilësitë e këngës popullore; ➤ rinjohin cilësitë e muzikës së lehtë; 	<ul style="list-style-type: none"> - J.S.Bah: Kantata fshatare (kantata) - J.Hajdën: “Stinët e vitit” (oratorio) - G F Hendël: “Mesia” (oratorio) - V.A.Moxart: Fyelli magjik (opera) - Xh.Rosini: Berberi i Seviljes (opera) - Xh.Verdi: Nabuko, Aida (opera) - P.Jakova: Mrika (opera) - Zh.Ofenbah: Tregimet e Hofmanit (operetta) - J.Shtraus: Lakuriqi (operetta) - T.Daija: Lejlaja (operetta) - P.I.Çajkovski: Liqeni i mjellmave (baleti) - R.Mulliqi: Nita (baleti) - F.Ibrahimi: Plaga e dhjetë e Gj.E.Alisë (baleti) - I.Stravinski: Petrushka (baleti) - M.Ravell: Bolero (vallja koreografike)

				<ul style="list-style-type: none"> - <i>L.Bernshtajn: Tregim nga perëndimi (mjuzikëlli)</i> - <i>A.Ll.Veber: Fantomi nga opera (mjuzikëlli)</i> - <i>B.Shehu: Lepuri me pesë këmbë (muzikë për film)</i> - <i>Xh.Horner: Titaniku (muzikë për film)</i> - <i>R.Rudi: Fluturimi mbi folenë e qyqes (muzikë për dramë)</i> - <i>R.Shtraus: Til Ojlenshpigel (poema simfonike)</i> - <i>F.Beqiri: Poema dramatike "Skënderbeu"</i> - <i>F.Shubert: solokëngë (homofonia)</i> - <i>J.S.Bah: Prelud (polifonia)</i> - <i>"Oj lulija jonë "(këngë popullore)</i> - <i>R.Mulliqi: "Baresha" (kompozim në frymën popullore)</i> - <i>P.Çako-R.Dilo: "Për një çast" (muzikë e lehtë)</i> - <i>Xh.Gershvin: Rapsodia Blu (xhaz)</i> - <i>G.Miler: "Fëmija Deni" (xhaz)</i>
--	--	--	--	--

I N T E R P R E T I M	<ul style="list-style-type: none"> • interpretojnë këngë artistike, popullore dhe të lehta shqiptare dhe të popujve të tjerë; • interpretojnë pjesë nga veprat artistike – muzikore të epokave dhe stileve të ndryshme; • ndërlihin me lëvizje dhe vallëzim interpretimin vokal, instrumental dhe vokalo-instrumental; • interpretojnë pjesë vokale dhe instrumentale në bazë të përjetimit individual; • cilësojnë dhe vlerësojnë interpretimet e veta dhe të të tjerëve; 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ këngë artistike, popullore dhe të lehta një, dy dhe shumëzërëshe; ➤ këngë, tema, melodi, kanone në tonalitete të njohura dhe të reja; ➤ dukuri të ndryshme ritmike – melodike; shkalla d-dur, h-mol, shkallët modale; ➤ Pjesë të ndryshme vokale, instrumentale dhe vokalo-instrumentale 	nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ➤ riinterpretojnë së paku gjysmën e numrit të këngëve dhe temave të përvetësuara duke përfshirë edhe luajtjen në instrumente; ➤ zbatojnë dukuritë ritmike dhe melodike të përvetësuara 	<ul style="list-style-type: none"> - S.Gjoni: Lule borë (këngë në frymën popullore) - Të gëzojmë (qytetare) - Kroi I fshatit tonë (qytetare) - L.V.Bethoven: Gjumi i natës (D-dur) - F.Shubert: Nina nëna - R.Shuman: Melodia (lojë instrumentale) - V.A.Moxart: Melodia (lojë instrumentale) - J.S.Bah: “Të vallëzojmë me gëzim” nga Kantata fshatare - Xh.Verdi: Kori I hebrenjëve nga opera Nabuko (tema) - V.A.Moxart: Aria e Papagenit nga opera Fyelli magjik (aria) - Xh.Verdi: “La donna mobile”- aria nga opera Rigoletto (aria) - P.Jakova: “Dielli ka prendue”- aria nga opera Mrika(aria) - I.Ferrari: Qyqja (kanon tre zërësh) - R.Sokoli: Kanon dyzërësh
K R I	<ul style="list-style-type: none"> • riinterpretojnë në mënyrë përjetuese dhe me mjete të shprehjes 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ këngët, meloditë, temat, kanonet; ➤ vepra sipas zgjedhjes; 	Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ➤ realizojnë disa nga format e propozuara 	

J I M	<i>estetike përmbajtjet e përvetësuar muzikore;</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>në bazë të përjetimit të veprës së dëgjuar, nxënësit shprehen përmes lëvizjes, shprehjes figurative dhe shprehjes letrare;</i> • <i>nxënësit shprehen në mënyrë kreative me mjetet shprehëse muzikore;</i> • <i>cilësojnë dhe vlerësojnë ngjarjet muzikore në mjedisin e tyre.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>plotësimet, ndryshimet melo-ritmike, krijimi i melodive – këngëve;</i> ➤ <i>shoqërime të ndryshme instrumentale dhe vokale;</i> ➤ <i>manifestimet muzikore të shkollës, koncertet, shfaqjet muzikore.</i> 	<i>të punës krijuese sipas prirjeve të tyre individuale;</i>	
----------------------------------	--	--	--	--

* * Në program është dhënë një numër më i madh i këngëve për interpretim dhe veprave për dëgjim me qëllim që mësimdhënësi të ketë mundësi të zgjedhë (në mesin e tyre) ata shembuj që u përshtaten më shumë kushteve dhe përparimit konkret të nxënësve.

UDHËZIME DIDAKTIKO-METODIKE

Mësimdhënia e Edukatës muzikore në klasën VIII kërkon racionalizim, si në planifikimin e kujdesshëm, ashtu edhe në realizimin e përmbajtjeve programore.

Kjo bëhet e mundur duke i koncipuar njësitë e gërshetuara në kuadër të veprimtarive: dëgjimi, interpretimi dhe krijimi. Në temat mësimore që paraqiten në vazhdimësi edhe në klasat e mëparme, tash kërkesat thellohen dhe zgjerohen, kurse shkoqitja e përmbajtjeve të reja duhet të bëhet duke patur parasysh mundësitë zhvillimore muzikore të nxënësve.

Njësitë mësimore shumëdimensionale janë në funksion të kësaj kërkesë në mënyrë që aktivizimi i nxënësve të jetë në përputhje me interesimet dhe me aftësitë individuale të tyre.

Kërkesat që paraqiten në përmbajtjet programore mbështeten dhe zgjidhen duke u mbështetur në:

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për dëgjim dhe interpretim.
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore, të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimit muzikor.
3. Informacionet për kulturën muzikore të mjedisit të nxënësit si dhe në formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë kombëtare dhe botërore.

DËGJIM

Procedura metodike e dëgjimit të veprave të përzgjedhura duhet të mundësojë **dëgjim aktiv**. Dëgjimi duhet të jetë **i shkurtër** dhe **i përsëritur**, gjë që do të mundësojë rritjen e përqendrimit të vëmendjes së nxënësit. Posaçërisht dëgjimi i përsëritur mundëson njohjen më të gjithanshme të veprave, kompozitorëve, epokave dhe stileve, si dhe formës muzikore e formacioneve interpretuese. Me përgatitje motivuese para dëgjimit dhe komentimet përkatëse pas dëgjimit, procedura mësimore pasurohet dhe bëhet më atraktive për nxënësin. Informatat kthyes si: të shprehurit e përjetimit të veprës së dëgjuar në forma të ndryshme, komenti për elemente të saj etj., janë primesa të dëgjimit analitik.

INTERPRETIM

Interpretimi realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në instrumente. Procedura metodike e këndimit bëhet: sipas veshit (imitimit), tekstit notal

dhe mënyrës së kombinuar (kur metoda sipas veshit dhe ajo sipas tekstit notal kombinohen) duke marrë parasysh mundësitë individuale të nxënësve. Luajtja në instrumente zbatohet në shoqërimin e këngëve dhe interpretimin e përmbajtjeve të veçanta instrumentale. Meqenëse përmbajtjet programore në këtë klasë janë kryesisht nga muzika vokalo-instrumentale, kërkesa për këndimin e temave ose të melodive të këtyre veprave është e arsyeshme. Nga aspekti metodik është mirë që këto të mësohen para dëgjimit të veprës, ngase kështu bëhen mbështetje dhe lidhje për përqendrimin e vëmendjes gjatë dëgjimit.

KRIJIM

Puna krijuese e nxënësit duhet të përshkohet nga spontaniteti dhe liria e të shprehurit përmes: krijimit të tërësive ritmike dhe melodike, lëvizjes, shprehjes figurative dhe letrare.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor në bazë të kërkesave profesionale didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit, duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore, shkathhtësitë interpretuese, dituritë informative, ndieshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet në bazë të përvetësimit të numrit të caktuar të këngëve dhe të përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar gjithnjë duke pasur parasysh mundësitë individuale të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe inkurajojë interesimin e nxënësit për shprehje kreative, në veçanti vlerësohet:

- rinjohja e veprave të dëgjuara,
- këndimi dhe luajtja instrumentale,

- diktimet melodike dhe ritmike,
- përgjigjet me goje dhe me shkrim,
- prezantimi,

instrumente të tjera të vlerësimit janë:

- testi,
- vetëvlerësimi.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultatet e arritshmërisë në vartësi nga objektivat e parashtruar.

FORMAT E VEÇANTA TË OBLIGUESHME TË MËSIMDHËNIES MUZIKORE

Puna me kor dhe me orkestër është formë e veçantë dhe e obligueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë të interpretimit muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore të niveleve të ndryshme, ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhënësit llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor prej 2- 4 orë (në vartësi nga niveli). Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezanton program me kritere artistike – pedagogjike.

HYRJE

Zhvillimin psikofizik të fëmijve, në vazhdimësi e bënë të avancuar kontributi i Artit figurativ. Andaj, si pjesë e jetës, i gërshetuar me të, art bëhet i rëndësishëm për sistemin arsimor në të gjitha nivelet, duke i kontribuar lidhjes ndërlëndore të të nxënimit dhe zbatimit në jetë.

Duke njohur e përjetuar gjithnjë e më shumë natyrën me fenomenet e dukuritë e saj shkencore si dhe ato shoqërore, nxënësit zhvillojnë të menduarit dhe shprehjen individuale figurative, përkatësisht ngritet kreativiteti, intuitsa artistike dhe mendimi kritik .

Ashtu si proceset zhvillimore natyrore që janë në repetacion (përsëritje) të përhershme, edhe arti pamor përsëritë proceset e punës figurative përmes lëmenjve, teknikave e mjeteve përkatëse, duke njohur e zbatuar zhvillimin më të avancuar të inteligjencisë, shkathtësisë shprehëse, imagjinatës kreative, terminologjisë figurative, përkatësisht ngritje multimediale.

QËLLIMET

Nxënësit trajtojnë përjetimet më të fuqishme për shprehje figurative, krijojnë ide apo koncept artistik me veçanti individuale e kreative.

Si trajtim për punën figurative sipas përsëritjes së njohurive ndaj fenomeneve e dukurive natyrore e shoqërore, lëmenjtë figurativë, teknikat e mjeteve shprehëse, do të përforcohet ekuilibri kompozicional [drejtpeshimi], uniteti apo harmonia e elementeve estetike, ndryshueshmëria si kontrast në formë, ngjyrë, lëvizje, drejtim, ritëm, përpjestim e alternativa të kombinuara sipas imagjinatës, intuitës e shkathtësisë individuale

OBJEKTIVAT

E PËRGJITHSHËM	SPECIFIKË
Nxënësit duhen:	
- <i>Të përceptojnë</i>	Trajtat natyrore e artificiale në hapësirë. Komponimin hapësinor.
- <i>Të përjetojnë e veçojnë</i>	Përpjestimet objektive. Relacioni: objekt e sfond apo formë e hapësirë.
- <i>Të dallojnë</i>	Dominantën dhe unitetin kompozicional.
- <i>Të krijojnë</i>	Alternativën individuale figurative. Harmoninë e bashkëpunimit kolektiv.
- <i>Të vlerësojnë</i>	Shkallën zhvillimore, të njohuritve të shprehjes figurative. Arritjet programore, kreativitetin dhe terminologjinë figurative.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES

Kategoria	Nënkategoria
I – Të vërejturit dhe perceptimi	1 - Hapësira = 5 orë 2 – Forma = 5 orë 3 – Sipërfaqja = 3 orë
II – Të shprehurit dhe kreativiteti	1 – Vija = 5 orë 2 – Ngjyra = 7 orë 3 – Harmonia = 5 orë
III – Analizë dhe vlerësim	1 – Komunikim = 4 orë 2 – Eseja = 3 orë

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoria I – TË VËREJTURIT DHE PERCEPTIMI

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet e pritshme
I-Hapësira	- KOMPONIMI hapësinor: - Interier (klasa, dhoma) - Eksterier (peisazh)	- Përmes teknikës së kolazhit të punohet komponim sipas natyrës e imagjinatës.	Nxënësi do të: - SAKTËSOJË perceptimin e thellësisë dhe ekuilibrin e formave. - KUPTOJË drejtpeshimin e përpjësimeve hapësinore.
2-Forma	- OBJEKTIVITETI (karakteri) natyror e imagjinitiv i formave të ndryshme.	- vizatim e pikturë i natyrës së qetë dhe i portretit.	- ZHVILLOJË E THELLOJË karakterin e objektit (formës) - DALLOJË llojllojshmërinë figurative reale e imagjinative
3-Sipërfaqja	- KOMPONIM i sipërfaqeve të ndryshme në sipërfaqe me përpjestim të caktuar.	- pikturim dekorativ me forma të sintetizuara dhe gjeometrike për zbatim në jetën e përditshme (zgrafito, qilimi, pllakati etj)	- KONCEPTOJË përpjesëtimet e sipërfaqeve - KREIROJË me sipërfaqe të ndryshme.

Kategoria II – TË SHPREHURIT DHE KREATIVITETI

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet e pritshme
1. Vija	Vija në elementet kompozicionale (forma, masa, ritmi, lëvizja) si bosht i komponimit figurativ.	Trajtim sipas natyrës apo imagjinatës me llojllojshmëritë e valerin e vijës. Në fazën e lodhjes psikofizike, të bëhet ILUSTRIM sipas literaturës nga lënda e gjuhës dhe historisë	Nxënësi do të: - ZBATOJË komponim linear.
2. Ngjyra dhe vëllimi	KOMPONIME të ndryshme sipas llojllojshmërisë së ngjyrave: kromatike e akromatike, valer, të ngrohta e të ftohta. VËLLIMI në komponim.	Trajtim i ngjyrës në formimin e komponimit me nuancim, valer, etj. Trajtim i vëllimit me ngjyrë e modelim.	- ZBATOJË ndieshmërinë individuale- - intuitën kreative dhe njohjen e mundësive shprehëse e kompozicionale të ngjyrës dhe të vëllimit.
3. Harmonia dhe kontrasti	UNITETI kompozicional i elementeve figurative, si harmoni, dhe dominimi i njërit si kontrast.	Trajtim i ndryshëm sipas llojllojshmërisë së elementeve figurative nëpër lëmenj teknika figurative. Preferohet punë sipas imagjinatës.	-NJOHË thelbin estetik të elementeve figurative për të rritur shprehjen e harmonisë dhe akcentimin me kontrast si reflektim mendor i ndonjë ideokoncepti të pavarur.

Kategoria III –ANALIZA DHE VLERËSIMI

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet e pritshme
1. Komunikimi	Reflektime rreth punimeve të vetë nxënësve dhe nga e kaluara artistike figurative.	- Seleksionim i vlerave të mira në punën gjithëpërfshirëse figurative të stimulojë qasjet dhe dashurinë më të madhe për shprehje joverbale (figurative) dhe verbale përmes njohjes së kulturës figurative globale.	Nxënësi do të : - KUPTOJË se arti figurativ zhvillon shpirtin e të bukurës si edukim moralo-shoqëror, arsimoro-shkencor dhe intelektualo-kreativ.
2. Eseja	Të përzgjidhet nga vetë nxënësit elementi shprehës i tipit figurativ si VETANALIZË verbale të formuluar në mënyrë të pavarur.	Përkrahje për vetafirmimin inteligjent e individual të nxënësit.	- MASOVIZOJË vlerat e kulturës figurative në shoqëri, përkatësisht rrethin ku jeton.

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

- Sipas zhvillimit psikofizik, për klasën VIII, kuptimi ndaj qasjes ndërlëndore e ndërprogramore, bëhet më i ngjeshur me fitimin e informacioneve arsimoro – shkencore e figurative të parapara për këtë nivel (moshë). Në këtë jetësim lidhen: letërsia, gjeometria, biologjia, historia etj.

VLERËSIMI

- Me arritjen e standardeve të planifikuara dhe të programuara si proces i të nxënësve, formohet edhe baza e vlerësimit sipas këtyre kritereve; njohja lëndore, kuptimi e zbatimi programor, puna e rregullt dhe e suksesshme nxënësve, aftësitë shprehëse individuale, përkatësisht kreativiteti, njohja më e pasur e terminologjisë lëndore dhe të shprehurit verbal si mendim kritik dhe inteligjent.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

- Vetëlidhshmëria e artit figurativ me jetën kërkon që procesin e mësimdhënies ta ndërtojë në mënyra të shumëllojshme si në metoda punuese të lidhura me lëmenj teknika e mjete pune, ashtu edhe me ekskursione të shkurtra (në formë vizitash) të galerive, muzeve apo ateleve të krijuesve figurativë të njohur në atë rreth e më gjerë.

PUNA PRAKTIKE (PËRVOJA E TË NXËNIT)

- Përshtatje aftësive praktike të nxënësve dhe kushteve punuese.
- Mirëkuptim i bashkëpunimit nxënës-arsimtar-nxënës si dhe arsimtar-prind-shkollë.
- Zbatueshmëria e kombinuar e metodave që ngrisin dashurinë ndaj shprehjes figurative për ndryshim të mjedisit jetësor.
- Masivizimi i së bukurës përmes ekspozitave dhe garimi si rritje e cilësisë artistike, aftësisë për zbatim në mjedisin ku jetojnë.
- Ndikimi përmes artit në globalizimin e kulturës multimediale.
- Kultivimi i rëndësisë së respektit, ruajtjes dhe kuptimit ndaj gjithë trashëgimisë arkeologjike, etnografike e artistike kombëtare e gjithënjëzore.

HYRJE

Në këtë klasë bëhet përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të nevojshme si: paraqitja e trupave, teknologjia e materialeve makinerike, transmetuesit dhe motorët, trafiku, teknologjia e përpunimit të ujit, përdorimi i pajisjeve teknike si dhe komunikimi me kompjuter.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së teknologjisë ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të njohur dhe kuptuar paraqitjen grafike të objekteve, projeksionin e pjerrët, aksonometrinë, prerjet e trupave, shpalosjen e sipërfaqeve, njohjen me materialet makinerike, teknologjinë e materialeve makinerike, transmetuesit dhe motorët, teknologjinë e përpunimit të ujit, përdorimin e pajisjeve teknike, trafikun si dhe zgjerimin e punës me kompjuter.
- Zhvillimin e shkathtësive për përpunimin e modeleve me materiale makinerike, si dhe disenjimin e objekteve me ndihmën e kompjuterit.
- Zhvillimin e shkathtësive të përhershme për mbledhjen e të dhënave relevante nga lëmi i teknologjisë dhe zbatimin e shkathtësive të fituara në situatat e ndryshme të jetës së përditshme.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të kuptojë

- Domethënien e termave të teknologjisë.
- Konceptet dhe parimet në projektionin e pjerrët, aksonometrinë, paraqitjen grafike të objekteve, materialeve makinerike, transmetuesit dhe motorët, teknologjinë e përpunimit të ujit, trafikun dhe komunikimin me kompjuter.

Të zbatojë

- Paraqitjen grafike të objekteve.
- Modele me materiale makinerike.
- Projektionin e pjerrët dhe aksonometrinë.

Të zhvillojë vlerat dhe qëndrimet

- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë i vullnetshëm, kooperativ, i hapur, me nisëtiivë, etj.).
- Në kuptimin e përparësive që i ofron lënda.

Të demonstrojë shkathtësi mendore

- Në marrjen e vendimeve të logjikshme gjatë zgjidhjes së problemeve.
- Në zgjidhjen e problemeve nga lëmenjtë e teknologjisë.
- Zbatimin e të menduarit kreativ dhe kritik.
- Propozimin e zgjidhjeve alternative.
- Demonstrimin e krijimeve origjinale.

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja
1. Paraqitja e trupave	1.1 Vizatimi i objekteve 1.2 Shpalosja e sipërfaqeve 1.3 Projektioni i pjerrët, Aksonometria	4	10,81%
2. Teknologjia e materialeve makinerike	2.1 Njohja me materialet makinerike 2.2 Vetitë e materialeve makinerike 2.3 Teknologjia e përpunimit të metaleve	7	18,92%
3. Transmetuesit dhe motorët	3.1 Transmetuesit dhe mekanizmat me gungë 3.2 Motorët me djegie të brendshme, turboraketorë dhe raketorë	6	16,22%
4. Trafiku	6.1 Të gjithë jemi pjesëmarrës në trafik 6.2 Njohja me motoçikletën	4	10,81%
5. Teknologjia e përpunimit të ujit	5.1 Uji teknik dhe uji i pijshëm 5.2 Përdorimi i ujit 5.3 Pastrimi i ujërave të zeza 5.4 Riciklimi i materialeve të përdorura	4	10,81%
6. Përdorimi i pajisjeve teknike	6.1 Pajisjet teknike shtëpiake 6.2 Pajisjet teknike dhe veglat për punë që përdoren në kabinet	4	10,81%
7. Komunikimi me kompjuter	7.1 Përmbajtja e internetit 7.2 Programi Internet Explorer	8	21,62%

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET QË DUHET ARRITUR	LIDHJA NDËRLËNDORE
1. Paraqitja e trupave	1.1 Vizatimi i objekteve	1.1.1 Vizatimi teknik i objekteve	Të njohë elementet e vizatimit teknik të objekteve.	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Art figurativ
	1.2 Shpalosja e sipërfaqeve	1.2.1 Projektionet aksonometrike dhe specifikat e tyre	Të njohë ndërtimin e projeksioneve izometrike.	
	1.3 Projektioni i pjerrët, aksonometria	1.3.1 Mënyra e shpalosjes së sipërfaqeve	Të njohë mënyrën e vizatimit të projeksioneve izometrike.	
2. Teknologjia e materialeve makinerike	2.1 Njohja me materialet makinerike	2.1.1 Prodhimi dhe njohja e metaleve dhe legurave (aliazheve)	Të njohë si prodhohen metalet dhe legurat (aliazhet).	Gjuhë amtare Fizikë Kimi
	2.2 Vetitë e materialeve makinerike	2.2.1 Njohja e vetive të metaleve dhe legurave (aliazheve)	Të njohë vetitë fizike, kimike, teknologjike dhe mekanike.	
	2.3 Teknologjia e përpunimit të metaleve	2.3.1 Mënyrat e përpunimit të metaleve dhe legurave (aliazheve)	Të njohë mënyrat e përpunimit të metaleve dhe legurat (lëmimi, pastrimi, farkimi, derdhja, ngjitja, mbrojtja sipërfaqësore, etj.)	
3. Transmetuesit dhe motorët	3.1 Transmetuesit dhe	3.1.1 Transmetuesit me zinxhirë 3.1.2 Transmetuesit me rripa	Të njohë parimin e punës së këtyre transmetuesve, si dhe përbërjen e tyre.	Gjuhë amtare Fizikë

	mekanizmat me gungë	3.1.3 Transmetuesit me leva 3.1.4 Mekanizmat me gungë		
	3.2 Motorët me djegie të brendshme, turboraketorë dhe raketorë	3.2.1 Motorët me djegie të brendshme 3.2.2 Motorët turboraketorë dhe raketorë	Të njohë makinat lëvizëse – motorët.	
4. Trafiku	4.1 Të gjithë jemi pjesëmarrës në trafik	4.1.1 Rreziqet në trafik për shkak të shpejtësisë 4.1.2 Statistika për numrin e fatkeqësive në trafik	Të njohë rreziqet në trafik për mosrespektim të shenjave dhe rregullave të trafikut.	Gjuhë amtare Fizikë
	4.2 Njohja me motoçikletën	4.2.1 Njohja me pjesët e motoçikletës 4.2.2 Mirëmbajtja teknike 4.2.3 Drejtimi i motoçikletës në poligonin e trafikut	Të njohë pjesët e motoçikletës dhe drejtimin e tij në trafik.	
5. Teknologjia e përpunimit të ujit	5.1 Uji teknik dhe uji i pijshëm	5.1.1 Njohja me ujin teknik dhe ujin e pijshëm	Të njohë ujin teknik dhe ujin e pijshëm. Burimet-resurset e ujit.	Gjuhë amtare Fizikë Gjuhë angleze
	5.2 Përdorimi i ujit	5.2.1 Kujdesi gjatë përdorimit të ujit	Të njohë dhe të vetëdijësohet për përdorimin e ujit.	
	5.3 Pastrimi i ujërave të zeza	5.3.1 Teknologjia e pastrimit të ujërave të zeza	Të njohë teknologjinë e pastrimit të ujërave të zeza.	

	5.4 Riciklimi i materialeve të përdorura	5.4.1 Mundësia e riciklimit të materialeve të përdorura	Të njohë mundësinë dhe teknologjinë e riciklimit të materialeve të përdorura.	
6. Përdorimi i pajisjeve teknike	6.1 Pajisjet teknike shtëpiake	6.1.1 Pajisjet teknike që përdoren për gatim dhe ruajtje të ushqimit 6.1.2 Pajisjet për ngrohje dhe mbajtje të temperaturës 6.1.3 Pajisjet për mbajtjen e higjienës dhe përgatitjes së shpejtë të ushqimit	Të njohë konstruksionin e shporetit elektrik, frigoriferit dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Të njohë konstruksionin e stufës termoakumuluese, klima pajisjes dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Të njohë konstruksionin e lavatriçes, bojlerit, ujtisë, mikserit dhe mënyrën e përdorimit të tyre.	Gjuhë amtare
	6.2 Pajisjet teknike dhe veglat për punë që përdoren në kabinet	6.2.1 Pajisjet për mësimdhënie: grafoskopi, kompjuteri, projektori, etj. 6.2.2 Veglat për punë që përdoren në kabinetin e teknologjisë	Të njohë pajisjet për mësimdhënie dhe veglat për punë.	
7. Komunikimi me kompjuter	7.1 Përmbajtja e internetit	7.1.1 Posta elektronike 7.1.2 Newsgroup 7.1.3 World Wide Web - Web-i 7.1.4 FTP (File Transfer Protocol)	Nxënësit duhet të njohin mundësitë kryesore të komunikimit, të cilat i ofron interneti përmes shërbimeve të veta.	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Lëndët shkencore etj.

		7.1.5 Chat 7.1.6 Net Meeting		
	7.2 Programi Internet Explorer	7.2.1 Startimi i programit 7.2.2 Adresa e Web-it 7.2.3 Pjesët strukturore të një Web-i – menytë, linket, kornizat, etj. 7.2.4 Veprimet kryesore: marrja e të dhënave nga Interneti (download), kopjimi, shtypja, etj. 7.2.5 Kërkimi i të dhënave sipas fjalëve kyçe (Search Engines, Google, etj.). 7.2.6 Hapja e adresës elektronike në Hotmail dhe Yahoo dhe shfrytëzimi i saj për komunikime (dërgimi i porosive, marrja e porosive, bashkëngjitja e dokumenteve kompjuterike një porosie (attachments), etj.	Aftësi të demonstruara në përdorimin e programit Internet Explorer. Shkathtësi të treguara në kërkimin dhe gjetjen e të dhënave përmes Internetit. Aftësi të demonstruara në hapjen e E-mail adresës dhe komunikimit përmes saj (dërgimi i porosive, dokumenteve, marrja e porosive, shtypja etj.). Shkathtësi të demonstruara në përdorimin e Web – faqeve me interes për mësim.	

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET DIDAKTIKE

Shpjegimi i përmbajtjes programore për të kuptuar paraqitjen grafike të objekteve, projektionin e pjerrët, aksonometrinë, prerjet e trupave, shpalosjen e sipërfaqeve, njohjen me materialet makinerike, teknologjinë e materialeve makinerike, transmetuesit dhe motorët, teknologjinë e përpunimit të ujit, përdorimin e pajisjeve teknike, trafikun si dhe zgjerimin e punës me kompjuter. Të realizohen shembuj konkretë për paraqitjen e trupave. Të bëhen provat me materiale makinerike. Të bëhen prova me transmetues dhe me motorë me djegie të brendshme, të njëjtat të realizohen sipas mundësisë edhe me modele të cilat mund të zbatohen me projektim në kompjuter. Të demonstronhet përpunimi i materialeve makinerike. Të njihet me teknologjinë e komunikimit përmes Internetit.

VLERËSIMI

Vlerësimi i të nxëniet bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë realizimit të përmbajtjes programore
2. Vlerësimi i punës individuale
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore
4. Testimi gjatë procesit të mësimit dhe ai përfundimtar
5. Vlerësimi përmes detyrës projektuese

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

Literatura e propozuar

1. Pajtim Bejtja, Alqi Mustafai, Eva Zagori, Renata Qatipi, Robert Tytymçe, Franko Kondakçi: “Teknologjia 1”, Tiranë, 2002.
2. Engjëll Tartari, Alqi Mustafai, Eva Zagori, Velesin Peçuli: “Teknologjia 2”, Tiranë, 2002.
3. Rexhep Berisha: “Arsimi teknik”, Klasa VI, VII, VIII, Prishtinë, 2001.

4. Boris Abersek, Franjo Florjancic, Amand Patopnik: "Tehnika 7", Lubjanë, 2000.
5. Literatura në gjuhën angleze për: MS Office 97, MS Office 2000, MS Office XP, etj.

Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme

1. Kabineti me pajisje për punimin e projekteve
2. Kabineti me kompjuterë dhe pajisje të tjera përcjellëse
3. Aplikacionet e nevojshme softverike
4. Lidhja në internet, rrjeti lokal në kabinet
5. Trajnime për arsimtarë
6. Mirëmbajtja

Kushtet minimale

1. Një kompjuter në shkollë për demonstrim të programit mësimor
2. Trajnime për arsimtarë

Vërejtje:

Në fondin e paraparë të orëve janë të përfshira ligjërimi, përforsimi i lëndës dhe testimi i nxënësve.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

1. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore, p.sh., evokim dhe reflektim 25%, demonstrimi 25%, puna individuale dhe grupore 50%
2. Inkurajimi i punës individuale dhe i shkëmbimit të dijes dhe të shkathtësive, puna interaktive
3. Përsëritja e përmbajtjes përmes detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

1. Puna grupore dhe individuale
2. Grupi i programerëve të shkollës

EDUKATË FIZIKE DHE SPORTIVE

2 orë në javë, 74 orë në vit

HYRJE

Përmes veprimeve lëvizore themelore dhe atyre rrethanore e sportive, nxënësve të kësaj grup- moshe duhet t'u mundësohet në mënyrë sa më të organizuar, të lirë e të hapur që t'i shprehin aftësitë e tyre lëvizore biologjike dhe të mësuar, të cilat duhet të bëhen përmes vlerësimit e kontrollit profesional të mësuesit të edukimit sportiv.

Përmbajtjet lëvizore duhet të jenë stimuluese, duke iu përshtatur aftësive e mundësive të zhvillimit të drejtë e sa më efektiv për të gjithë nxënësit, qofshin ata me pengesa të ndryshme aftësish, apo me dhunti lëvizore.

QËLLIMET

Përmes programeve të hartuara të përshtatura me kushtet zbatuese e aftësitë e verifikuara të nxënësve, atyre duhet sa më saktë t'u mundësohet:

- (1)zhvillimi i aftësive lëvizore e funksionale po ashtu edhe rritja dhe mbrojtja e shëndetit,
- (2)zbulimi dhe mënjanimi apo zvogëlimi i mangësive lëvizore, mundësisht edhe të atyre psikosomatike,
- (3)formimi i shprehive lëvizore sportive dhe memorimi sa më i lartë dhe më i gjatë i tyre për zbatim në jetën reale dhe në sport,
- (4)përzgjedhja e qëlluar e nxënësve në disiplinat e mundshme sportive, posaçërisht në sportet olimpikë etj.

Për zbatimin e qëllimeve kryesore kërkohet organizim cilësor nga aktivi i mësuesve të edukimit sportiv përmes strukturave udhëheqëse të

shkollës, të komunës e më lart, përfshirë edhe bashkëpunimin e ngushtë me prindër dhe organizatat joqeveritare, duke i përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë në interes të fëmijëve tanë.

OBJEKTIVAT

Kuptimet orientuese themelore mund të lidhen me:

1. Të zhvilluarit e aftësive trupore dhe trunore përmes aktivitetit lëvizor të programuar;
Përvetësimin e mjeshtrive të ndryshme sportive;
Formimin e qëndrimit të drejtë trupor e mendor në ballafaqim me situata të ndryshme praktike në klasë, në shkollë e më gjerë në shoqëri, etj.
2. Udhëheqja, kontrolli e korigjimi real i objektivave programore nga ana e mësuesit duhet të objektivizohet përmes:
 - 2.1. Matjeve në fillim të vitit shkollor, në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit me masa si: centimetër, sekondë dhe kilogram dhe zbatimit të njohurive e përmasave,
 - 2.2. biomekanike e teknike të lëvizjeve mjeshtrorë sportive .

PËRMBAJTJA PROGRAMORE	Nr. i orëve
1. VLERËSIMI I AFTËSIVE LËVIZORE	4 orë
2. ATLETIKË	12orë
3. GJIMNASTIKË SPORTIVE DHE RITMIKE	14 orë
4. SPORTET KOLEKTIVE	24 orë
5. SPORTET INDIVIDUALE	12orë
- sportet luftarake	
- sportet me raketë	8 orë
6. SKIJIMI-NOTIMI ¹	7-10 ditë
7. PIKNIQET DHE FUSHIMI	2 ditë në vit
8. GARA SPORTIVE SË PAKU NË DY SPORTE (SIPAS KUSHTEVE)	

¹ Mësimi organizohet në terren të përshtatshëm për ski e not në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, prindërit dhe institucionet e tjera

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	Numri i orëve (%)
ANTROPOMETRI DHE MOTORIKË	Vlerësimi i veçorive antropometrike dhe i aftësive lëvizore	(A) -Pesha e trupit (PT), - Lartësia e trupit (LT), etj. (M) - Kërcim nga vendi në gjatësi,(KVGJ) - Kërcim nga vendi në lartësi (KVL), - Vrapim 100 metra(V100m), - Vrapim 600mF-800mM dhe dy teste nga mjeshtëria e të mësuarit.	4 orë 5.4%
ATLETIKË	Vrapime Kërcime Hedhje Gara (në 2 disiplina)	Përsosje e mjeshtërisë së vrapimit (teknikë), kërcimeve dhe hedhjeve përmes: - Vrapimit të shpejtë, - Vrapimit stafetar dhe rritjes së qëndrueshmërisë në shtigje më të gjata se 600m për femra dhe 800m për meshkuj. - Ushtrimeve për kërcyeshmëri. - Kërcimit të lartë “fosberi”. - Hedhjes së topthave deri 300gr. - Shtytjes së gjyles 4kg. - GARA brenda e në mes të paraleleve së paku në dy disiplina ku duhet të rangohen nxënësit dhe grupëzohen në tri grupe sipas rezultateve.	12-14 orë 6.2-18.9 %
GJIMNASTIKË SPORTIVE DHE RITMIKE	Kërcime Ushtrime në dysHEME Në hekur Në unaza	- Kërcimi i kaluqit për së gjati me këmbë hapur e mbledhur. - Kërcimi i kalit për së gjati me këmbë hapur. - Ura nga qëndrimi i shtrirë - rrotullimi para me mbështetje në duar. - Rrotullimi prapa me mbështetje në duar. - Rrotullimi para dhe prapa me mbështetje në duar. - Rrotullimi para dhe mbapa nga mbështetja shaluar mbi duar (hehuri). - Nga lëkundja para dhe prapa kalim në varje palosur (unaza).	10-12 orë 13.5-16.2%

	<p>Në paralele</p> <p>Në traun gjimnastikor</p> <p>Në kali me dorëza</p> <p>Valle popullore dhe vallëzim modern</p> <p>Gara (2)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nga lëkundje para dalje me kthim për 180°. - Nga mbështetje mbi krahë ngritje me lëkundje para në mbështetjen në duar. (paralele - meshkujt). - Lëkundje ballore në drushtin e lartë, në drushtin e ulët rrotullimi prapa dhe i shaluar, (paralele - femrat). - Përsëritje e elementeve të klasës së shtatë duke i komponuar. - Lëkundja nga mbështetja para dhe prapa. - Ushtrime përmes lëvizjeve ciklike e aciklike me topa, rrathë, litar e shishe druri. Hapat e valsit, rokut dhe dy valle popullore (vallet popullore dhe vallëzimi modern). - Brenda e mes paraleleve së paku në dy vegla. 	
SPORTE KOLEKTIVE	Futboll	<p>Pasimi dhe marrja e topit në lëvizje me kundërshtar gjysmaktiv dhe aktiv.</p> <p>Udhëheqja e topit gjysmaktiv dhe aktiv.</p> <p>Driblingu-mashtrimi me top dhe rrëmbimi i topit.</p> <p>Mbrojtja dhe sulmi grupor dhe ekipor.</p> <p>Futboll i vogël 7:7 me zbatim të rregullave elementare.</p>	
	Hendboll	<p>Përforcimi i lëvizjeve themelore (teknike) pa dhe me top si, gjuajtjet , pranimet, udhëheqjet etj.</p> <p>Stërvitja e formave të kundërsulmit grupor dhe kolektiv dhe të mbrojtjes individuale në gjysmën e fushës dhe në tërë fushën.</p> <p>Sulmi kolektiv me një pivot dhe mbrojtja zonale 6:0 me kalim në atë 5:1 me arbitrim.</p>	26 orë
	Volejbol	<p>Përsëritja e lëvizjeve teknike si dëbimi, pasimi, marrja dhe gjuajtja e topit etj.</p>	

		Shërbimi nga lart "tenis" dhe blloku Volejboll 6:6 me zbatim të rregullave elementare.	
	Basketboll Gara	Përforsim i elementeve tekniko-taktike si dhënia e topave bashkëlojtarit përmes formave lëvizore të ndryshme dhe gjuajtjeve në kosh etj. Loja 3:3, 4:4, me arbitrim. Brenda e mes paraleleve së paku në dy sporte kolektive.	
SPORTE INDIVIDUALE	Sportet luftarake- Xhudo	Njohja me teknikën themelore të lëvizjeve të xhudos si: kapjet e ndryshme rëniet etj.	
	Pingpong	Përsosje të teknikës themelore të goditjes me pëllëmbë me shpinë dhe goditje me rrotullim. Mësimi i shërbimeve bashkëkohore dhe i sistemeve të garave individuale e ekipore.	
	Roshula Gara (2)	Mësimi i lëvizjeve themelore të rrëshqitjes me roshula si para, prapa me ndalje, lëvizje gjysmëharkore etj., me shpejtësi adaptuese. Brenda e mes paraleleve së paku në dy njësi mësimore të kaluara.	6-12 orë
Aktivitete në ujë 7-10 ditë	Teknikat e notit: Gara	Përsosja e stileve të mësuara (krol, bretkosë). Të mësuarit e krolit në shpinë dhe lojëra me kërcime të lira në ujë. Stil i lirë	7-10 ditë

Aktivitete në borë 7-10 ditë	Disiplinat alpikë Gara	Përsosje e teknikës themelore të rrëshqitjes me ski si ecje, kthime, lëshime (disiplina alpikë). Lidhja e dy e më shumë kthimeve në terrene të përshtatshme për këtë grup-moshë . Në sllallom të madh në shteg të përshtatshëm për këtë grup- moshë.	7-10 ditë
Gara shkollore	Gara në sportet kolektive dhe individuale Krosi pranveror dhe vjeshtor	Së paku në dy degë sportive në kuadër të shkollës dhe ndërmjet shkollave të komunës, zonës e atyre finale e shtetërore për grup- mosha të caktuara me të dy gjinitë, krosi pranveror dhe vjeshtor	10-12 orë 16.2%
Shëtitje	Shëtitje në natyrë dy herë në vit	Ecja në natyrë me konfiguracion 6-12 km. Elemente të orientimit në natyrë dhe të kampingut (zgjedhja e kampit dhe vendosja e një tende). Lojëra të ndryshme të terrenit.	

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Në bazë të kushteve që ka shkolla përshtaten përmbajtjet programore duke bërë,

- përfshirjen rreth 70% të përmbajtjeve programore (analizo tabelën) si mësim i obliguar ndërsa
- rreth 30% mësim zgjedhor

Metodologjia realizuese. Në procesin e mësimit të lëvizjeve në edukimin sportiv, pa marrë parasysh mjetet e konkretizimit që i ka shkolla, patjetër duhet zbatuar:

- demonstrimi praktik i njësive lëvizore nga ana e mësuesit të edukimit sportiv apo të ndihmësit të tij (nxënës, sportist). Në vartësi nga aftësitë e nxënësve dhe shkallës së ndërlikueshmërisë së lëvizjes, mësuesi zgjedh ecurinë metodologjike të ushtrimeve, duke u bazuar në radhë të parë
- në formën sintetike (tërësinë lëvizore), analitike apo kombinimi i të dyjave. Po ashtu, organizimi i orës mësimore bëhet në vartësi me kushtet, objektin, rekuizitat dhe numrin e nxënësve. Duhet bërë përpjekje që komplekset lëvizore përmbyllëse lidhur me kategoritë e nënkategoritë të cilat zbatohen, të finalizohen me lojë e garë.

Arritshmëria. - Në disiplinat lëvizore ku rezultatet mund të vlerësohen në masa metrike objektive si centimetër, sekondë, gram mësuesi i edukimit sportiv duhet të evidencojë gjendjen fillestare, pastaj atë kaluese dhe së fundi atë përfundimtare, duke bërë renditjen dhe grupëzimin e nxënësve së paku në tri grupe (të dalluar, mesatar e me aftësi të kufizuara). Për lëvizjet ku nuk mund të kemi masa metrike të sakta duhet bërë përpjekje që niveli i arritshmërisë të lidhet me shkallën e përvetësimit të mjeshtrisë së lëvizjeve nga aspekti i teknikës shkollore, stilit të notimit dhe duke pasur parasysh anën e drejtë biomekanike të lëvizjeve (me përshkrim).

Ndërlidhja me lëndët e tjera. - Orari mësimor, organizimi i orës së edukatës sportive, duke përfshirë edhe ngarkesat gjatë orës duhet të jenë asisoj që të ndikojnë në mënyrë motivuese për lëndët e tjera të asaj dite shkollore.

Njësitë mësimore të kategorive e nënkategorive të përfshira ndërli-
dhen, duke filluar nga matematika, informatika deri te lëndët biologjike e
shkencat e tjera në hierarkinë disiplinare e interdisiplinare të emërimeve.

VLERËSIMI

- vlerësimi i zhvillimit trupor ashtu si në klasën paraprake, të masave antropometrike bëhet 2 herë në vit. E detyrueshme është lartësia e trupit dhe pesha e trupit, po do të ishte mirë të mateshin edhe masat e tjera si indi dhjamor etj.
- Vlerësimi i aftësive motorike bëhet me sistemin CGS (centimetër, gram, sekondë). Instrumentet matëse obliguese janë: kërcim nga vendi në gjatësi, kërcim nga vendi në lartësi, vrapimi 100m dhe vrapimi 800m për femra dhe 1000m për meshkuj.
- Shkalla e informatave të mësuara lidhur me lëvizjet rrethore (sportive) vlerësohet individualisht dhe gjatë situatave të lojës dhe garës.

LITERATURA

1. Edukata fizike dhe sportive, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004 (Libra të publikuar)
2. Hendboll, Prof.dr. Faik Çitaku;
3. Basketboll, Prof.dr. Masar Nixha;
4. Volejbol, Prof.dr. Enver Gjinolli;
5. Atletika, Prof.dr. Hysen Rakovica;
6. Futboll, Prof.dr. Enver Gjinolli;
7. Ski, Prof.dr, Masar Nixha- Mr.Aziz Dujaka;
8. Metodika e Edukatës fizike, Beqir Hasangjekaj-ligjërues;
9. Sate Practice- in Physical Edukation- Baalpe.
10. Ditari i edukimit sportiv, Instituti i Antropologjisë Sportive, 2003

Tirazhi: 2000 copë
E përgatiti për shtyp
*SHTËPIA BOTUESE **LIBRI SHKOLLOR*** – Prishtinë
U shtyp në Shtypshkronjën PRINTING PRESS - Prishtinë

Katalogimi në publikim – CIP
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

PLANI dhe programi mësimor : Për klasën VIII të shkollës së mesme të ulët / [Kryeredaktor Isuf Zeneli].- Prishtinë : Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : “Printing Press”).- 252 fq.; 24 cm.

Literatura pas kapitujve

ISBN 9951-450-59-8